



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në:
“Specialist Pajisjesh Elektronike”
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Gazment QATIPI

Dr. Alketa GREPCKA

Gazment Qatipi
Alketa Grepcka

Nëntor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 228, datë 10.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 i KSHK
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022; 49 studentë; 2022-2023; 25 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit 2 –vjeçar me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike” ofrohet në Univerisitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit i hapur përmes Urdhër MASR Nr. 228 Prot, datë 10.07.2020. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI) përbëhet nga tre njësi bazë respektivisht:

1. Departamenti i Matematikës;
2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
3. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;

Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Kjo njësi ofron programe studimit duke mbuluar 3 programe studimit të ciklit të parë, 2 programe studimi Master Profesional dhe 1 program profesional jouniversitar. Departamenti i Teknologjise se Informacionit (DIT) zotëron një staf që zë 31.8 % të numrit total të stafit akademik të FTI-së. DIT ka ruajtur në vite numrin e tij duke përbushur standartet ligjore.

Programi i studimit 2 – vjeçar me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike” është ndërtuar mbështetur në dispozitat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë, ndarja e lëndëve në kurrikul është organizuar duke u bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018 për “Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Ky program ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe kompetenca tek studentët në perfundim të studimeve të tyre në përputhje me Nivelin 5 të Kornizës Shqiptare. Programi i studimit 2 – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total ka 120 kredite. Ngarkesa vjetore është 30 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 23. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe.

Programi i studimit 2–vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” zhvillon kompetenca të nevojshme për studentin për një formim të specializuar në fushën e fushën e aplikimit të pajisjeve elektronike për të krijuar specialistë dhe kërkues të përgatitur në këtë fushë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Mars 2023. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur FTI/UAMD për të përbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. UAMD, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat per hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Përgjegjës të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, takim me grupin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit, takim me stafi akademik të angazhuar në programin e studimit, takim me studentët në këtë program studimi. GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve, Sektorit të Burimeve Njerëzore, Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikimit. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.09.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 13/151 Prot, datë 20.09.2023. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës më datë 30.10.2023, njofton nëpërmjet shkresës me Nr. 1892/1 Prot, datë 26.10.2023, që nuk ka komente mbi Draft Raportin. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kriteret	Vlerësimi
Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	IAL “Aleksandër Moisu” Durrës ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” kontribuon në përgatitjen e specialistëve në fushën e elektronikës të cilët do të përmbushin të gjithë kërkesat e tregut të punës në rajon dhe në vend në këtë fushë. <i>[Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit 2 - vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është hartuar bazuar në Misionin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit. Neni 3 në Statut të UAMD shpreh qartë parimin mbi të cilin institucioni zhvillon veprimtarinë akademike <i>[Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD]</i> . Neni 4 përcakton qëllimet e Universitetit ku vlen të citojmë pikën 3 të saj: UAMD ka për qëllim: <i>a. Të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar dhe ndërkombëtare të punës;</i> <i>b. Të formojë shkencëtarë të rinj, nëpërmjet punës kërkimore – shkencore të nivelit më të lartë bashkëkohor;</i> <i>c. Të realizojë kualifikime shkencore të personelit akademik në fushën e shkencave të mirëfillta teorike e të shkencave të zbatuara;</i> <i>d. Të tërheqë specialistët më të mirë, të krijojë kushte, të nxisë dhe inkurajojë rritjen e aftësive akademike dhe të kontributit të tyre;</i> <i>e. Të kryejë studime shkencore për të zhvilluar dije të qëndrueshme, si edhe për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit;</i> GVJ konstaton një përputhshmëri të misionit të institucionit me misionin e programit të studimit. Konkretisht neni 6 në

	<p>Rregulloren e Programit të Studimit jep qartë misionin e hapjes së programit dy – vjeçar të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”. Citojmë në këtë aspekt disa nga pikat kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Të ofrojë një trajnim të plotë teknik në fushën e elektronikës; b. Të sigurojë që njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë program të kualifikojnë studentët për sfida të ndryshme praktike në profesionin e tyre dhe t'i aftësojnë ata për të kontribuar në risitë e ardhshme teknologjike në fushën e elektronikës; c. Të aftësojë studentët në ndërtimin, kontrollin, implementimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike të përdorura në sektorin publik dhe privat; d. Të kombinojë njohuritë teorike dhe praktike të fushës së elektronikës për të realizuar detyra të ndryshme; e. Të përgatisë studentët për të vazhduar progresin në fushën e kualifikimit më të avancuar profesional; <p><i>[Evidencë. 23 Rregullore e programit të studimit, neni 6]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit 2 - vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është hartuar bazuar në dokumentat institucionale të UAMD-së. Mënyra e organizimit të studimeve studimit është në përputhje me aktet ligjore të shprehur ne Statut të UAMD-së <i>[Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD, Kreu VI – Statut të UAMD-së]</i>. Programi i studimit është hapur në vitin 2020 dhe është vijim i punës që institucioni zhvillon në drejtim të Planit të Zhvillimit Strategjik 2020-2025 <i>[Evidenca 8. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025]</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>GVJ konstaton se në shërbim të programit të studimit dhe të plotësimit të misionit dhe objektivave të tij të shprehur edhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Institucionit UMAD ndërmerret edhe studim të tregut të punës <i>[Evidenca 8. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Evidenca 4. Strategjia-per-Arsimin-2021-2026]</i>. Në studimin e tregut të punës njësia bazë është fokusuar në mundësitë për punësim të studentëve në përfundim të studimeve të tyre. Studimi është i bazuar në trendin teknologjik në rajon dhe në botë dhe kërkesat për punësim në vend. Ndër profesionet për mundësi punësimi në lidhje me studentët e diplomuar në këtë program</p>

studimi evidentojmë:

- a. *Mirëmbajtje dhe riparime të pajisjeve kompjuterike (kompjuterë personale të të gjithë tipeve, monitorë, printera, skaner, fotokopje, plotter etj);*
- b. *Instalim dhe riparim sisteme sigurie dhe monitorimi (sisteme video, sisteme alarmi, sisteme mbrotje nga zjarri etj);*
- c. *Riparim të pajisjeve mobile (smartphone, tablet, minikompjuter, sisteme GPS etj);*
- d. *Riparim pajisjesh elektronike (karikues, blloqe ushqimi, konvertues, chipsete etj);*
- e. *Instalim dhe konfigurim të programeve kompjuterike;*
- f. *Instalim dhe mirëmbajtje rrjete kompjuterike;*
- g. *Instalim dhe mirëmbajtje pajisjes POS (point of sale);*
- h. *Instalim, konfigurim dhe regjitrin në sistemet back-end te kompanive te biznesit;*

[Evidenca 9. Misioni dhe studimi i tregut të punës]

Në takimin e zhvilluar në Institucion me zyrën e Komunikimit, Karrierës & Alumni u theksua edhe roli që kjo strukturë jep në lidhje me studimin e tregut të punës. Ky i fundit ndërmerret nga Institucioni 1 – 2 here në vit dhe në bashkëpunim me Fakultetin e Biznesit hartohet edhe pyetjet në pyetsor. Fokusi kryesor në këtë drejtim është përthithja e të dhënave nga kompanitë private në rajonin e Durrësit kryesisht në moshën e punësimit, kërkesën për pjesëmarrje, drejtimet e biznesit dhe eksperiencën, progresin në rritje e kompanisë dhe synimi i saj, praktika profesionale dhe ndihmesa nga ana e kompanive në këtë drejtim *[takim me përfaqësues të Zyrës së Komunikimit, Karrierës & Alumni]*.

Institucioni mban edhe një database në lidhje me ndjekjen e punësimit të studentëve në përfundim të studimeve të tyre *[evidenca 47. Database Punesimesh al e fundit, Shtator 2022]*.

GVJ konstaton se ndonëse strukturat brenda Institucionit janë të angazhuara në lidhje me matjen e kërkesës së tregut të punës, studimet mungojnë për këtë program studimi. Studimi i fundit i përkët viti 2019 kur institucioni ka filluar aplikimin për hapjen e programit të studimit.

GVJ rekomandon që hapa të mëtejshëm në këtë drejtim

	<p><i>duhen kryer për të matur tendencat e tregut të punës në shërbim të përmbajtjes së programit të studimit dhe të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” zhvillohet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (FTI) i krijuar në vitin 2010. Kjo njësi kryesore përbëhet nga tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Departamenti i Matematikës;</i> <i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike;</i> <i>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (ku zhvillohet edhe programi i studimit SPE);</i> <p>FTI ka angazhuar (për vitin akademik 2022-2023) 44 pedagogë si staf PAE, 30 PAK dhe 20 staf ndihmës akademik. Referuar fushës individuale të kualifikimit konstatojmë së personeli i angazhuar në programin e studimit me karakter profesional “Specialist pajisjesh elektronike” disponon formimin e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore <i>[Evidenca 10. Personeli akademik i angazhuar në NJKTI; Evidenca 14. Liste MoU per publikim; CV STAFI];</i></p> <p>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI) përgjegjës për programin e studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” ka angazhuar 14 pedagoge si staf PAE, 2 PAK dhe 2 punonjës si staf ndihmës akademik <i>[evidence: Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike].</i></p> <p>UAMD ka krijuar në drejtim të programit të studimit një infrastrukturë të duhur. Procesi mësimor zhvillohet në ambiente në përputhje me standartet për salla leksioni, seminare dhe orë laboratorike <i>[vizitë në institucion, takime në institucion];</i></p> <p>Struktura ndihmëse si biblioteka, sekretaria mësimore, zyra e Komunikimit, Karrierës & Alumni janë në shërbim të studentëve në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është koduar me kodin S52PP0619 bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi <i>[Evidenca 11. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD].</i></p> <p>Programi i studimit zhvillohet në Fakultetin e Teknologjisë</p>

<p>studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>sëe Informacionit, në Departmentin e Teknologjisë së Informacionit. DTI ofron programe në dy cikle të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Cikli i parë: “Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”;</i> • <i>Cikli i parë: “Bachelor ne Sistemet e Informacionit”;</i> • <i>Cikli i parë: “Bachelor ne , Multimedia dhe TV Dixhital”</i> • <i>Cikli i dytë: “Master Profesional në Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndermarrjes”</i> • <i>Cikli i dytë:”Master Profesional Multimedia dhe TV Dixhital”;</i> <p><i>[Evidenca 50. Programet e studimit të ofruara në NJKTI.]</i></p> <p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të FTI-së dhe DTI-së.</p>
--	--

Konkluzione

- *Programi i studimit 2 - vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është hartuar bazuar në Misionin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit.*
- *Mënyra e organizimit të studimeve studimit është në përputhje me aktet ligjore të shprehur ne Statut të UAMD-së.*
- *GVJ konstaton një përputhshmëri të misionit të institucionit me misionin e programit të studimit.*
- *Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është koduar me kodin S52PP0619 bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi. GVJ konstaton se ndonëse strukturat brenda Institucionit janë të angazhuara në lidhje me matjen e kërkesës së tregut të punës, studimet mungojnë për këtë program studimi.*

GVJ rekomandon që Departamenti të bëjë një studim tregu të ri, për të matur tendencat e tregut të punës në shërbim të përmbajtjes së programit të studimit dhe të studentëve.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UAMD ka të mirëpërcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për njësitë kryesore dhe njësitë bazë. Statuti përcakton hollësisht organizmin, strukturat përbërëse të tij, veprimtarinë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, përzgjedhjen e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritet drejtuese, detyrat e personelit akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe të studentëve [Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD]. Kuadri i brendshëm i veprimtarisë rregullohet përmes zbatimit të Rregullores UAMD, dhe Rregulloreve të Njësisë Kryesore (FTI), Rregullores së Programit të Studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” [Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit]. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara edhe për strukturat administrative në funksion dhe shërbim të programit të studimit. GVJ konstaton rregullore të veçanta për Drejtorinë e Administrimit të Shërbimeve Akademike, Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënive me Jashtë, Sektorin e Komunikimit, Alumni dhe Karrierës të cilat bashkërendisin punën e tyre me njësitë bazë dhe kryesore të UAMD-së [Evidenca 28. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; Evidenca 30. Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënive me Jashtë; Evidenca 43. Rregullore e sektorit të komunikimit, Alumni dhe karrierës]. Veprimtaritë për çdo vit akademik shprehen përmes raporteve vjetore të cilat finalizohen me raportin vjetor institucional të UAMD-së, një kopje e të cilës dorëzohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Njësitë bazë të FTI-së organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njëra tjetrën. Kjo duket edhe në mësimdhënie, ku disa prej lëndëve të këtij programi studimi mbulohen nga staf akademik i njësive të tjera bazë të këtij fakulteti dhe në përgjithësi të këtij universiteti. Në lidhje me këtë program studimi 4% e lëndëve mbulohen nga personeli akademik i Departamentit të Matematikës dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe 12% e ngarkesës mbulohen nga personel akademik i njësive të tjera kryesore të UAMD-së</p>

	[evidencë:RVB, kriteri 5, fq.6].
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit konstaton punën e institucionit në lidhje me zgjerimin e veprimtarisë së tij përmes bashkëpunimeve me institucione të tjera të Arsimit të Lartë dhe me kompani private. Konkretisht UAMD ka nënshkruar 53 marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja homologe në dy vitet e fundit. GVJ konstaton përpjekje edhe nga përfaqësues të FTI-së në këtë drejtim [Evidenca 13. Marrëveshjet e nënshkruara në vitet 2021, 2022; Evidenca 14_Lista e marrëveshjeve me Universitete brenda dhe jashtë vendit)]. GVJ ndërmorri në ditën e dytë një takim të veçantë me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve. Ky sektor përbëhet nga dy njësi të veçanta përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sektori i Projekteve; b. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë; <p>Në këtë sektor angazhohen në total 14 veta si staf administrativ duke fokusuar punën e tyre në rritjen e pjesëmarrjes së UAMD në projekte ndërkombetare dhe zgjerimit të fushës së bashkëpunimit me institucione jashtë vendit. Në kuadër të organizimit të Panairit të Karrierës, Zyra e Komunikimit, Alumni & Karrierës nënshkruan edhe marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë e biznesit pjesëmarrës në event [takim në institucion].</p> <p>Në kuadër të Erasmus + mobilitete janë përfituar nga stafi akademik. GVJ u njoh me të dhëna statistikore të paraqitura nga institucioni për mobilitet të stafit akademik në tërësi ndërsa në takime të zhvilluara në institucion konstatohet si vijon më poshtë për FTI-në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. 4 staf akademik kanë përfituar mobilitet në Estoni, Suedi, Hollande; b. 3 staf akademik (incoming) kryesisht nga Letoni, Estoni; <p>[Evidenca 15_Të dhëna mbi mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve, takim në institucion];</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës</p>	<p>GVJ konstaton marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë private në kuadër të programeve mësimore të FTI-së. Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” nuk përfshin në përmbajtjen e tij praktikën profesionale. Për sa më sipër, GVJ konstaton se</p>

<p>përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>institucioni nuk shfrytëzon potencialin e mundësive të këtyre bashkëpunimeve në kuadër të zhvillimit të praktikës profesionale për këtë program studimi [<i>Evidenca 18. Plani mësimor i programit të studimit</i>].</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ nuk gjeti evidenca të hartimit të raporteve në drejtim të përfitimeve në kuadër të bashkëpunimit me kompanitë e biznesit. Mungesa e praktikës profesionale në përmbajtjen e programit mësimor sjell edhe në mosndjekjen e përfitimeve të realizuara përmes bashkëpunimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Karrierës & Alumni i ngritur në UAMD është aktiv në realizimin e aktiviteteve që sjellin kompanitë e biznesit më pranë UAMD-së. Ky sektor ka ngritur strukturat e tij në të dy ndërtesat (Currila dhe Kampus) ku në secilën prej tyre janë të punësuar dy specialistë të cilë në mënyrë aktive organizojnë në bashkëpunim me njësitë bazë konferenca studentore, ëorkshope, mësim të hapura duke sjellë edhe përfaqësues të biznesit për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët [<i>takim në institucion</i>].</p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>UAMD ka të mirëpërcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për njësitë kryesore dhe njësitë bazë. Statuti i UAMD-së përcakton hollësisht organizmin, strukturat përbërëse të tij, veprimtarinë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, përzgjedhjen e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritet drejtuese, detyrat e personelit akademik, ndihmës-akadmeik, administrativë dhe të studentëve.</i> • <i>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit konstaton punën e institucionit në lidhje me zgjerimin e veprimtarisë së tij përmes bashkëpunimeve me institucione të tjera të Arsimit të Lartë dhe me kompani private.</i> • <i>GVJ konstaton marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë private në kuadër të programeve mësimore të FTI-së. Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” nuk përfshin në përmbajtjen e tij praktikën profesionale. GVJ konstaton se institucioni nuk shfrytëzon potencialin e mundësive të këtyre bashkëpunimeve në kuadër të zhvillimit të praktikës profesionale për këtë program studimi.</i> • <i>GVJ nuk gjeti evidenca të hartimit të raporteve në drejtim të përfitimeve në kuadër të bashkëpunimit me kompanitë e biznesit. Mungesa e praktikës profesionale në përmbajtjen e programit mësimor sjell edhe në mosndjekjen e përfitimeve të realizuara përmes bashkëpunimeve.</i> 	
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se UMAD harton politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë. Kreu VII në Statut përcakton qartë parimet e funksionimit të sigurimit të brendshëm të cilësisë [Evidenca 5. Statuti-miratur-UAMD]. Me vendim të Senatit Akademik është miratur edhe Rregullorja për “Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë” [Evidenca 17.Rregullore e NJSBC]. Hartimi i kësaj rregullore dhe funksionimi i NJSBC në UMAD bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 103,104,106 dhe 46; - Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë miratur me VKM nr.531, datë 11.09.2018; - Standartet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SUE); - Statutin e UAMD-së; - Rregulloren e UAMD-së; - Manualin e ASCAL për Sistemin e Brendshëm të Cilësisë;
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Strukturat përbërëse të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UAMD ndahen në dy nivele në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Përkatësisht dallojmë:</p> <p><u>Në Nivel Institucional:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Senati Akademik;</i> - <i>Komisioni i Perhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë (KPGSC);</i> - <i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) – 7 anëtarë;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL); - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC); <p>Në nivel Njësi Kryesore përgjegjës për sigurimin e standarteve të cilësisë është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (5 anëtare) ku për programin në shqyrtim është NjsBC në FTL.</p> <p>GVJ konstaton në dokumentacionin e paraqitur një riorganizim të kësaj njësie në nivel institucional dhe Fakulteti në vitin 2021 [Evidenca 12. Urdher per ngritjen e NjsBC; Evidenca 22. Urdhër Koordinatorët dhe NjsBC].</p> <p>GVJ konstaton përfaqesine e studentëve në përbërjen e komisioneve në nivel institucional dhe fakulteti.</p> <p>UAMD ndjek një strategji të mirëpërcaktuar në drejtim të sigurimit të cilësisë. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> A) Pyetsorit të studentit i cili mat performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie; B) Vlerësimin të përgjegjës të DTI-së për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore; [Evidenca 44. Pyetesor Student UAMD].
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD ka të percaktuar qartë në Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë instrumentat për garantimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë konsiderohet i rëndësishëm nga ana e Institucionit. GVJ konstaton në Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD-së 2020-2025, një vend të veçantë sigurimit të jashtëm të cilësisë. Citojmë këtu: “..Objektiv i rëndësishëm është edhe akreditimi periodik i Institucionit dhe i programeve të studimit, me qëllim përmirësimin, konsolidimin dhe forcimin e cilësisë që qëndron në themel të shërbimeve të ofruara nga UAMD” [Evidenca 8. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025]. UAMD ju nënshtrova në vitin 2022 procesit të Akreditimit Institucional dhe u vlerësua me një Akreditim për 4 vite akademike [VBA Nr.18, datë 24.03.2022; 24/03/2022 deri në 23/03/2026]. Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.</p>

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.

GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe mendimet e shprehura në takimin me përfaqësues të zyrës së NJSBC-së dhe konstaton si vijon më poshtë:

- a. UAMD përdor tregues të qartë dhe të matshëm përmes NJSBC e cila në fund të çdo semestri ndërmerr anketime tek studentët. Pyetsorët kanë rubrika të veçanta për vlerësimin e stafit akademik, infrastrukturës dhe përmbajtjes së lëndës dhe literaturës. Të dhënat e mbledhura për vlerësimin e pedagoqeve i raportohen përgjegjësit të njësisë bazë dhe individualisht stafit akademik ndërsa të dhënat në lidhje me infrastrukturën dhe përmbajtjen e lëndës bëhen publike dhe diskutohen në mbledhjet e departamentit. Institucioni paraqet rezultatet e pyestorëve në njësinë bazë (DTI) e cila më pas shqyrton edhe mundësitë për përmirësimet e duhura [*takim ne institucion; Evidenca 44. Pyetesor Student UAMD; Evidenca 45. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)*].
- b. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ nuk evidenton të dhëna të qarta në lidhje me problematikat e shprehura nga studentët për këtë program studimi. Eventualisht në takimin e zhvilluar me përfaqësues të NJSBC-së u theksuan disa nga çështjet kryesore të ngritura nga studentët ku përmendim:
 - *Programi i studimit është kërkuar të ofrohet gjatë fundjavës përkatësisht në ditën e Premte, të Shtunë dhe të Djelë pasi shumica e studentëve janë të punësuar. Në lidhje me këtë njësi bazë ka marrë në shqyrtim kuadrin ligjor dhe janë bërë propozimet përkatëse në Senatin Akademik ku pritet edhe miratimi i tij [*takim me NJSBC-në*].*

Konkluzione

- *GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se UAMD harton politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë;*
- *Institucioni ka hartuar bazuar në kuadrin ligjor Rregulloren për “Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”;*
- *Strukturat përbërëse të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UAMD ndahen në nivel institucional dhe nivel njësi kryesore në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;*
- *UAMD përdor tregues të qarte dhe të matshem përmes NJSBC e cila në fund të çdo semestri ndërmerr anketime tek studentët. Pyetsorët kanë rubrika të veçanta për*

vlerësimin e stafit akademik, infrastrukturës dhe përbajtjes së lëndës dhe literaturës;

- Institucioni paraqet rezultatet e pyestorëve në njësinë baze (DTI) e cila më pas shqyrton edhe mundësitë për përmirësimet e duhura;

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” i ofruar nga FTI është konform legjislacionit në fuqi. Programi është i organizuar në lëndë dhe module me vlerësim në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i organizuar në 120 kredite ECTS dhe zhvillohet me kohë të plotë në një kohëzgjatje në 2 vite akademike me nga 2 semestra secili. Secili vit akademik parashikon aktivitete didaktike të vlerësuara 60 kredite ECTS. Plani mësimor konsiston në 23 veprimtari formuese duke përfshirë edhe provimin përfundimtar. Të gjitha lëndët kanë kodet përkatëse të tyre. <i>[Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit; Evidenca 11. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku	Programi i studimit me karakter profesional 2 vjecar “Specialist Pajisjesh Elektronike” i korrespondon Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke fituar njohuritë, afësitë dhe kompetencat për të mundësuar punësimin si: • <i>Mirëmbajtjes dhe riparues të pajisjeve kompjuterike</i>

<p>përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p><i>(kompjuterë personale të të gjithë tipeve, monitorë, printera, skaner, fotokopje, plotter etj);</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Mirëmbajtës dhe riparues Sisteme Sigurie dhe Monitorimi (sisteme video, sisteme alarmi, sisteme mbrojtje nga zjarri etj);</i> • <i>Mirëmbajtës dhe riparues të pajisjeve mobile (smartphone, tablet, minikompjuter, sisteme GPS etj);</i> • <i>Mirëmbajtës dhe riparues pajisjesh elektronike (karikues, blloqe ushqimi, konvertues, chipsete etj)</i> • <i>Mirëmbajtës dhe konfigurues të paketave të programeve kompjuterike (ëindoës, Microsoft Office, Adobe, Autodesk etj);</i> • <i>Mirëmbajtës të rrjeteve kompjuterike;</i> • <i>Mirëmbajtës pajisjesh POS (point of sale);</i> • <i>Operator në sistemet back-end të kompanive të biznesit; [Ev. Evidenca 23. Rregullorja e programit]</i> <p>GVJ është i mendimit se njohuritë e përfuara në këtë cikël studimi krijojnë shprehi të veçanta për të ushtruar një shumëllojshmëri relativisht të gjerë profesionale e specialitetesh të lidhura me fushen elektronike.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva formues të qartë për formimin profesional të studentëve. Ky program synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>T'i aftësojë studentët mbi zhvillimin e produkteve elektronike;</i> • <i>T'i aftësojë studentët për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve dhe pajisjeve elektronike ekzistuese dhe të reja;</i> • <i>T'i aftësojë studentët në njohjen e komponenteve të pajisjeve elektronike, qarqeve, gjysmëpërçueseve dhe sistemeve;</i> • <i>T'i aftësojë studentët në marrjen e vendimeve teknike të duhura në pajisjet e bizneseve;</i> • <i>T'i pajisë studentët me njohuritë e duhura në mënyrë që të jenë në gjendje të përshtaten vazhdimisht me kushtet e ndryshimit;</i> • <i>Të kombinojë njohuritë teorike dhe praktike të fushës së elektronikës për të realizuar detyra të ndryshme;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojë që njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë program të kualifikojnë studentët për sfida të ndryshme praktike në profesionin e tyre; • Të aftësojë studentët me strategji sistematike në zgjidhjen e problemeve teknike; • Të aftësojë studentët në ofroimin e shërbimeve teknike këshilluese; <p>GVJ gjeti objektivat formues në dokumentacionin për hapjen e programit të studimit dhe aspak në rregulloren e programit të studimit. <u>GVJ rekomandon përfshirjen e objektivave formues në Rregulloren e programit të studimit.</u></p> <p><i>[Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit; Evidenca 23. Rregullorja e programit]</i></p>																														
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë edhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional 2 vjecar “Specialist Pajisjesh Elektronike, përmban të gjitha elementët e strukturës të programit të studimit, në përputhje me Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar dhe ligjit të arsimit të lartë në RSH. Forma e studimeve të programit është me kohë të plotë dhe gjuha e programit është shqip. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Numri i përgjithshëm i disiplinave të nevojshme për t’u diplomuar, së bashku me provimin perfundimtar është 23.</p> <p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Të gjitha disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, E C, D dhe E janë të detyrueshme.</p> <table border="1" data-bbox="614 1534 1388 1960"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>ECTS</th> <th>%</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>18</td> <td>15%</td> <td>15-20 %</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>60</td> <td>50%</td> <td>50-55 %</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td> <td>24</td> <td>20%</td> <td>12-15 %</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale</td> <td>12</td> <td>10%</td> <td>10-15 %</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmblyëse/ Provimi perfundimtar</td> <td>6</td> <td>5%</td> <td>3-5 %</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi	A	Lëndë Bazë	18	15%	15-20 %	B	Lëndë karakterizuese	60	50%	50-55 %	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	24	20%	12-15 %	D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	12	10%	10-15 %	E	Detyrime përmblyëse/ Provimi perfundimtar	6	5%	3-5 %
Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi																											
A	Lëndë Bazë	18	15%	15-20 %																											
B	Lëndë karakterizuese	60	50%	50-55 %																											
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	24	20%	12-15 %																											
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	12	10%	10-15 %																											
E	Detyrime përmblyëse/ Provimi perfundimtar	6	5%	3-5 %																											

	<p><i>[Evidenca 23. Rregullorja e programit. Evidenca 18. Plani mesimor i programit te studimit; Evidenca 21. Syllabust e kurseve (te firmosura); Tabela Permbledhese per programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike]</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Numri i përgjithshëm i disiplinave të nevojshme për t'u diplomuar, së bashku me provimin perfundimtar është 23.</p> <p>Pranimet e studenteve ne programin e studimit dy – vjecar “Specialist Pajisjesh Elektronike” zhvillohet ne perputhje me aktet ligjore në fuqi si edhe me vendim të veçantë të komisionit ad-hoc të ngritur nga Dekanati i FTI-së në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara nga Senati Akademik i UMAD-së. Neni 29 dhe 30 në Rregulloren e programit të studimit përcaktojnë qartë procedurën e pranimit të studentëve në këtë program studimi <i>[Evidenca 23. Rregullorja e programit]</i>.</p> <p>Në lidhje me mbështetjen financiare UMAD bazohet në kuadrin ligjor të shprehur në VKM nr.93 date 21.12.206 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e kriterëve për perfitimn e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentet e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” të ndryshuar me Vendimin nr.39 date 23.01.2019 të Keshillit të Ministrave.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional dy – vjecar “Specialist Pajisjesh Elektronike” është unik në RSH. Bazuar në takimet ne institucion dhe në RVB konkludojmë se ky program është mbi 70% i ngjashëm në përmbajtjen me programe të tilla në rajon <i>[Raporti i Vleresimit te Brendshem _Programi_Specialist Pajisjesh Elektronike; takime ne institucion; Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit]</i>.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të</p>	<p>Programi i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MASR. Ky program i përket kodit: S52PP0619.</p> <p><i>[Evidenca 11. Kodifikimi i Programeve te Studimit UAMD]</i></p>

programit.				
Konkluzione				
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Programi i studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” e ofruar nga FTI është konform legjislacionit në fuqi. Programi është i organizuar në lëndë dhe module me vlerësim në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i organizuar në 120 kredite ECTS dhe zhvillohet me kohë të plotë në një kohëzgjatje në 2 vite akademike me nga 2 semestra secili. Secili vit akademik parashikon aktivitete didaktike të vlerësuara 60 kredite ECTS. Plani mësimor konsiston në 23 veprimtari formuese duke përfshirë edhe provimin përfundimtar.</i> • <i>Programi i studimit ka objektiva formues të qartë për formimin profesional të studentëve</i> • <i>Programi i studimit me karakter profesional dy – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elektronike” është unik në RSH.</i> • <i>Programi i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MASR.</i> 				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (FTI) i organizuar në tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike;</i> 2. <i>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;</i> 3. <i>Departamenti i Matematikës;</i> <p>Programi i studimit zhvillohet në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtuesin e njësisë kryesore dhe bazë janë të shprehur qartë në Rregulloren e UAMDS-së dhe të programit të studimit. <i>[Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit].</i></p> <p>Njësia Kryesore përmbush të gjithë detyrimet ligjore për zhvillimin e programeve të studimit përmes angazhimit të një</p>

	stafi akademik me grada shkencore dhe me eksperiencë.																																	
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit/ Departamentet</th> <th colspan="5">Stafi akademik me grada shkencore</th> </tr> <tr> <th>Lektor (Prof)</th> <th>Lektor (Prof.As.)</th> <th>Lektor (Dr.)</th> <th>Lektor (PhDc)</th> <th>As.Lektor (MSc)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Departamenti i Shkencave Kompjuterike</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>9</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>6</td> <td>6</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Departamenti i Matematikës</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>8</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>					Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit/ Departamentet	Stafi akademik me grada shkencore					Lektor (Prof)	Lektor (Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Lektor (PhDc)	As.Lektor (MSc)	Departamenti i Shkencave Kompjuterike	-	-	4	9	2	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	-	1	6	6	1	Departamenti i Matematikës	-	4	8	2	1
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit/ Departamentet	Stafi akademik me grada shkencore																																	
	Lektor (Prof)	Lektor (Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Lektor (PhDc)	As.Lektor (MSc)																													
Departamenti i Shkencave Kompjuterike	-	-	4	9	2																													
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	-	1	6	6	1																													
Departamenti i Matematikës	-	4	8	2	1																													
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit angazhon një staf ndihmës akademik me përvojë. Vizita në Institucion presantoi edhe praninë e tyre në laboratorë dhe punën përkatëse dhe përgjegjësitë e secilit <i>[vizitë në institucion]</i> .																																	
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Rregullorja e programit të studimit përcakton edhe koordinatorin e programit detyrat dhe përgjegjësitë kryesore janë të shprehur në nenin 10 të saj <i>[Evidenca 23. Rregullorja e programit, pika ii; Evidenca 22_ Vendimi për përcaktimin e koordinorëve të programeve të studimit]</i>.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për trajtimin e problematikave të evidentuara gjatë procesit mësimor apo të ngritur edhe nga studentet. Në takimin e zhvilluar me stafin akademik koordinatori ndau edhe eksperiencën dhe përvojën në këtë drejtim <i>[takim në institucion]</i>.</p>																																	
Konkluzione																																		
<ul style="list-style-type: none"> • Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (FTI) i organizuar në tre departamente; • Njësia Kryesore përmbush të gjithë detyrimet ligjore për zhvillimin e programeve të studimit përmes angazhimit të një stafi akademik me grada shkencore dhe me eksperiencë. • Rregullorja e programit të studimit përcakton edhe koordinatorin e programit detyrat dhe përgjegjësitë kryesore janë të shprehur në nenin 10 të saj. 																																		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht																														

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi																		
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit me karakter profesional 2- vjeçar në “Specialist Pajisjesh Elektronike” paraqitet i detajuar në elementët e tij që përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Planin mësimor;</i> - <i>Rregulloren e programit të studimeve;</i> - <i>Programet (syllabuset) e lëndëve;</i> - <i>Modelin e diplomës.</i> <p><i>[Evidenca 11. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD; Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit; Evidenca 21. Syllabust e kurseve (te firmosura); Evidenca 23. Rregullorja e programit].</i></p> <p>Ky informacion i shoqëruar me kuotat dhe kriteret e përvitshme të pranimit përbëjnë informacionin bazë të programit të studimit, i cili disponohet nga DTI dhe që vihet në dispozicion të studentëve.</p>																		
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përcakton ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese;</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave;</i> - <i>Dhënien për secilën lëndë të ngarkesës në kredite dhe numrit të orëve në auditor dhe pune të panvarur;</i> <p>Referuar nenit 14 në Rregulloren e programit të studimit 1 ECTS të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit. GVJ shqyrtoi me vëmendje përmbajtjen e programit mësimor, planit mësimor dhe syllabuset për çdo lëndë në këtë program studimi.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Semestri</th> <th>Ngarkesa në auditor (orë)</th> <th>Punë e panvarur (orë)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Semestri I</td> <td>225</td> <td>525</td> </tr> <tr> <td>Semestri II</td> <td>225</td> <td>525</td> </tr> <tr> <td>Total Viti I</td> <td>450</td> <td>1050</td> </tr> <tr> <td>Semestri I</td> <td>225</td> <td>525</td> </tr> <tr> <td>Semestri II</td> <td>180</td> <td>570</td> </tr> </tbody> </table>	Semestri	Ngarkesa në auditor (orë)	Punë e panvarur (orë)	Semestri I	225	525	Semestri II	225	525	Total Viti I	450	1050	Semestri I	225	525	Semestri II	180	570
Semestri	Ngarkesa në auditor (orë)	Punë e panvarur (orë)																	
Semestri I	225	525																	
Semestri II	225	525																	
Total Viti I	450	1050																	
Semestri I	225	525																	
Semestri II	180	570																	

Total Viti II	405	1095
Total	855	2145

GVJ konstaton:

- Mungesë të ndarjes të ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare, laboratorë projekte etj. Në rregulloren e programi të studimit neni 15 dhe 16 përcaktojnë se veprimtaria mësimore zhvillohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, ushtrimeve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit dhe praktikës. Neni 16 “Elementët e Studimit” citojmë: “*elementët kryesore të studimit janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, projektet e kursit, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare të kursit, provim/temë diplome*”. Për sa me sipër, GVJ nuk gjen të dhëna në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës përkatësisht për pjesën teorike dhe praktike. Në takimet e zhvilluara në Institucion u theksua që pjesa teorike dhe praktike (orët e seminareve dhe laboratorike) janë të inkorporuar brenda orës mësimore por GVJ nuk vërejt një procedurë të qarte në këtë drejtim.
- GVJ nuk gjen të përfshirë në programin mësimor praktiken profesionale. Takimet e zhvilluara në institucion shprehen qarte nevojën për kryerjen e saj.

GVJ nga konstatimet e gjetura rekomandon si vijon më poshtë:

- *Paraqitjen në planin mësimor të ngarkesës për orë ushtrimesh dhe orë laboratorike;*
- *Vendosjen e praktikës profesionale si një rubrikë e veçantë në programin mësimor.*

[Evidenca 23. Rregullorja e programit. Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit; Evidenca 21. Syllabust e kurseve (te firmosura); Tabela Permbledhese per programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike]

Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe elementë që lidhen me shkallën e detyrueshme të frekuentimit, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, përmirësimin e notave, mënyrën e diplomimit etj.

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet

Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe

<p>e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>ekuivalentimit të krediteve jepen në Rregulloren e IAL UMAD-së, NJKFTI-së, Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional dy - vjeçar "Specialist Pajisjesh Elektronike" [Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI.; Evidenca 23. Rregullorja e programit]. Në takimin e zhvilluar në institucion u shpreh si problematikë mesatarja e ulët e pranimit të studentëve [takim në institucion].</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit përmban informacion të nevojshëm për programet lëndore përmes syllabuseve të hartuar nga titullaret e lëndëve. Organizimi i studimit përfshin ndërthurjen brenda orës së mësimi të pjesës teorike me praktikën. Bazuar edhe në kriterin 3 të këtij standarti, GVJ shqyrtoi edhe përmbajtjen e syllabuseve dhe nuk gjen evidencë në lidhje me tematikën e orëve praktike dhe laboratorike [Evidenca 21. Syllabust e kurseve (te firmosura)].</p> <p><i>Për këtë GVJ rekomandon: Paraqitjen e tematikës së ushtrimeve dhe orëve laboratorike në përmbajtjen e syllabusit për çdo lëndë.</i></p> <p>GVJ shqyrtoi edhe mënyrën e vlerëimit tëshprehur në syllabuse me formën e vlerësimit të shprehur në rregulloren e programit të studimit pëkatësisht neni 23 dhe gjen një përputhje midis tyre. [Evidenca 23. Rregullorja e programit; Evidenca 21. Syllabuset e kurseve (te firmosura); Evidenca 26_Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e sistemit të vlerësimit të studentëve)].</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Përmbajtja e programit mësimor është në përmirësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik bëhen edhe përmirësimet deri në masën 20% kryesisht në përmbajtjen e lëndës. Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë këtë masë që në liçencimin e tij nga MASH [Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit; Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit].</p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • GVJ konstatoi se programi i studimit me karakter profesional 2- vjeçar në “Specialist Pajisjesh Elektronike” paraqitet i detajuar në elementët e tij që përfshijnë: Planin mësimor; Rregulloren e programit të studimeve; Programet (syllabuset) e lëndëve; Modelin e diplomës. • Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përcakton ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese. GVJ konstaton mungesë të ndarjes të ngarkesës në 	

auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare, laboratorë projekte etj.

- GJV nuk gjen të përfshirë në programin mësimor praktiken profesionale. Takimet e zhvilluara në institucion shprehen qarte nevojën për kryerjen e saj.

GJV rekomandon:

1. Paraqitjen në planin mësimor të ngarkesës për orë ushtrimesh dhe orë laboratorike;
 2. Vendosjen e praktikës profesionale si një rubrikë e veçantë në programin mësimor.
- Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë këtë masë që në licencimin e tij nga MASH.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GJV është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikës profesionale mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve.</p> <p>GJV shqyrtoi edhe të dhënat statistikore në lidhje me numrin e studentëve të diplomuar dhe të punësuar. Nga tabela përmbledhëse e paraqitur nga institucioni konstojmë se numri i studentëve të diplomuar është shumë i ulët. Nga 118 studentë të regjistruar në tre vite akademike 2020-2023 vetëm 1 student është i diplomuar. Në takimet e zhvilluar në institucion stafi akademik shprehu si problematikë mesataren e ulët të studentëve e cila paraqet problematikë në asimilimin e kuadrit teorik. Për sa më sipër GJV shqyrtoi edhe përmbajtjen e programit mësimor i cili nuk ka pësuar ndryshime që në momentin e licensimit të tij nga MASH. Secila lëndë është 6 ECTS duke sjellë një ngarkesë dhe trajtim të njëjtë të të gjithë grupeve të lëndëve në kategorite A-E. Për sa më sipër <u>GJV rekomandon një rishikim të lëndëve në programin mësimor duke pëcaktuar realisht</u></p>

	<p><i>peshën e secilës në raport me rëndësinë e tyre. Në lidhje me aftësimin profesional të studentëve konsiderimi i praktikës profesionale në programin mësimor është një domosdoshmëri [takim në institucion, Evidenca 18. Plani mësimor i programit të studimit].</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga vlerësimi i planit mësimor, GVJ konstatoi se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional [Evidenca 18. Plani mesimor i programit te studimit]. Eventualisht, duke ju referuar takimit me studentët, <i>do të rekomandohej integrimi në programin e studimit i praktikës profesionale dhe nga takimi me përgjegjesin e DTI-së do të rekomandohej vlerësimi në orë i seminarëve dhe punës laboratorike.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ rithekson edhe njëherë mungesën e paraqitjes së orëve praktike me teorike. Bazuar edhe në DVV dhe në tabelën përmbledhëse të paraqitur nga institucioni nuk jemi në gjendje të konkludojmë për një plotëm të raportit teori me praktikë. Nga institucioni janë paraqitur në total 855 orë ngarkesë në auditor e cila përfshin orët e leksioneve, seminareve dhe orët laboratorike [Tabela Permbledhese per programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike; Evidenca 18. Plani mesimor i programit te studimit].</p> <p>GVJ në këtë drejtim përforcon <i>rekomandimin</i> e dhënë me sipër për paraqitjen e ngarkesës të orëve në seminare punë laboratorike në planin mësimor e cila do të shërbejë për të vlerësuar me saktë aftësimin praktik të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ nuk gjeti evidencë në lidhje me raportin teori – praktikë. Nga ana e GVJ pyetje të shumta u zhvilluan në këtë drejtim gjatë takimeve në institucion dhe ndonëse nga stafi akademik u theksua që raporti teori-praktikë është i barabartë dhe në shumë raste angazhohen me tepër në anën praktike për të bërë studentin të asimilojë më qartë konceptet teorike, GVJ duke u bazuar në mungesën e evidencave rithekson paraqitjen e tematikave të seminareve dhe orëve laboratorike, ngarkesën përkatëse të tyre në planin mësimor si një domosdoshmëri për të vlerësuar arritjen e objektivave formues [takime në institucion].</p> <p>Në këtë program studimi studentët nuk kanë përfituar mobilitet dhe nuk ka të dhëna në lidhje me punësimin pasi vetem 1 student është i diplomuar dhe ai figuron në tabelën</p>

	<p>përmbledhësë vetëm si i diplomuar <i>[takim në institucion; Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike; takim me zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare].</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se ato janë të përditësuara me literaturë bashkëkohore. Kryesisht literatura e detyruar është cikël leksionesh dhe literatura e rekomanduar është e 10 viteve të fundit. GVJ konstaton 4 lëndë të cilat kanë nevojë në rifreskimin e tyre me literaturë të detyruar të 5 viteve të fundit. Përmbajtja e syllabuseve përmirësohet në fillim të çdo viti akademik dhe shembuj të përmirësimit të tyre u sollën nga stafi akadmeik në takimin e zhvilluar në institucion <i>[Evidenca 21. Syllabuset e kurseve (te firmosura); takim me stafin akademik].</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Në programin mësimor me karakter dy – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elektronike” <u><i>mungon praktika profesionale.</i></u> Ndonëse UAMD/FTI ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me kompanitë e biznesit bashkëpunimi me punëdhënësit mungojnë në këtë drejtim për shkak të mos angazhimit të studentëve në praktikën profesionale <i>[Evidenca 13. Marreveshjet e nënshkruara në vitet 2021, 2022].</i></p> <p>GVJ konsideron që kryerja e Internshipit, marrja e përvojës praktike dhe vlerësimi i studentëve në këtë element të programit do të sjellë përmirësime në drejtim të aftësisë të studentëve dhe në përballjen e tyre me kërkesat reale të tregut të punës. Për sa më sipër GVJ gjykon një rishikim të programit mësimor përmes futjes së praktikës profesionale si një modul të veçantë <i>[Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit; Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit;].</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Programi i studimit dy-vjeçar me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike”, në tërësinë e tij i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe është në përputhje me nivelin 5 të KSHK-së.</p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e 	

veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikës profesionale mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve.

- GVJ konstaton që programi mësimor i cili nuk ka pësuar ndryshime që në momentin e licensimit të tij nga MASR. Secila lëndë është 6 ECTS duke sjellë një ngarkesë dhe trajtim të njëjtë të të gjithë grupeve të lëndëve në kategorite A-E. Për sa me sipër GVJ rekomandon një rishikim të lëndëve në programin mësimor duke pëcaktuar realisht peshën e secilës në raport me rëndësinë e tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ konstaton një përmirësim në përmbajtjen e çdo lënde deri në masën 20%. Përmirësimet burojnë nga të dhënat statikore të paraqitura nga NJSBC, nga zhvillimet teknologjike dhe nga përmirësimet në kushtet laboratorike përmes investimeve të bera nga institucioni <i>[takime në institucion]</i> . Mungesa e praktikës profesionale dhe numri i ulët i studentëve të diplomuar përbën një faktor të mos përthithjes së mendimit të punëdhënësit dhe alumni në lidhje me kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.	DTI në bashkëpunim me koordinatoren e programit dhe NJSBC bashkërendojnë punën në lidhje me përfundimin e mendimit të studentëve. Zyra e Komunikimit, Alumni & Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar ndonëse për këtë program studimi numri i ulët i tyre nuk mund të japë qartë mendimin e studentëve dhe të pasqyrojë reflektimet e duhura nga ana e DTI-së për përmbajtjen e programit të studimit dhe përmirësimet e duhura që duhet të ndërmerren. Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të NJSBC-se u theksua problematika e hasur ku numri i ulët i studentëve të diplomuar është një indikator negativ për programin e studimit <i>[takim me përfaqësues të NJSBC-së]</i> .

	<p>NJSBC harton një pyetsor të njëjtë për të gjithë programet e studimit. GVJ konstaton se mungesa e praktikës profesionale, mungesa e bashkëpunimit me kompanitë e biznesit dhe numri i ulët i studentëve të diplomuar përbëjnë disa tregues që institucioni duhet ti marrë në konsideratë në analizën vjetore për programin e studimit.</p> <p><i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u> hartimin e një pyetsori të veçantë për studentët në këtë program studimi ku të përthithet më mirë mendimi i tyre [takime ne institucion].</i></p>
--	---

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>DTI në fillim të çdo viti akademik kryen përmirësimet e duhura në programin mësimor kryesisht në masën 20% bazuar në zhvillimet teknologjike, ekseperienat e përfuara përmes mobilitetit të stafit akademik (incoming-outgoing), pjesëmarrje në projekte kërkimore – shkencore [takime në institucion].</p>
---	--

<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ konstaton një përmirësim në përmbajtjen e çdo lënde deri në masën 20%. Përmirësimet burojnë nga të dhënat statikore të paraqitura nga NJSBC, nga zhvillimet teknologjike dhe nga përmirësimet në kushtet laboratorike përmes investimeve të bera nga institucioni.</i> • <i>GVJ konstaton se numri i ulët i studentëve të diplomuar nuk mundëson përthithjen e mendimit të alumni në drejtim të përmbajtjes së programit mësimor dhe përmirësimet që duhet të bëhen në këtë drejtim.</i> • <i>GVJ konstaton së NJSBC zhvillon një pyetsor të njëjtë për të gjithë programet e studimit në UMAD. <u>GVJ rekomandon</u> hartimin e një pyetsori të veçantë për këtë program studimi me qënëse alumni, bashkëpunimi me kompanitë e biznesit mungojnë dhe nuk përthithet mendimi i tyre nga institucioni.</i> 				
--	--	--	--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>DTI zbaton kuadrin ligjor në lidhje me format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive. GVJ konstaton në <i>nenin 15</i> të rregullores së programit të studimit format kryesore të mësimdhënies [<i>Evidenca 23. Rregullorja e programit</i>]. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, ushtrimeve, detyrave të kursit, praktikës. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75-100%. Elementët e studimit janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare dhe provimi final [<i>Evidenca 23. Rregullorja e programit, neni 15 dhe 16</i>].</p> <p>GVJ konstaton se ora mësimore është e organizuar në leksione, seminare dhe orë laboratorike. Nuk ka një ndarje të përcaktuar qartë midis teorisë dhe praktikës. Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u theksua fleksibiliteti që kjo mënyrë organizimi jep tek studentët dhe stafi mësimor. Në fillim të orës mësimore bëhen ushtrime në lidhje me temën e dhënë një javë më përpara dhe në fund të saj zhvillohet pjesa teorike pasardhëse [<i>takim me stafin akademik</i>]. GVJ nuk evidenton në syllabuse dhe në planin mësimor tematikat dhe ndarjen e orëve të teorisë, seminareve, detyrave të kursit dhe punëve laboratorike [<i>Evidenca 21. Syllabuset e kurseve (te firmosura); Evidenca 18. Plani mesimor i programit te studimit</i>].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Për programin e studimit 2 – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” angazhohet një staf akademik me përvojë dhe i përkushtuar [<i>Evidenca: CV stafi akademik</i>]. Personeli akademik i përgjigjet nevojave të studentëve. Forma të veçanta u përdorën gjatë situatës së shkaktuar nga Covid-19 ndonëse nga ana e studentëve pati kërkesa për më shumë orë praktike. Në lidhje me procesin mësimor stafi akademik bën përpjekje në drejtim të asimilimit të kuadrit teorik përmes zbatimit të saj në praktikë. Fleksibiliteti i organizimit të orës së mësimi u jep mundësinë që për çështje që janë të vështira të trajtohen më gjerësisht nga ana e stafit akademik [<i>takim me stafin akademik, takim</i>].</p>

	<p><i>me drejtues të DTI-së].</i></p> <p>Në shërbim të programit të studimit është edhe një staf ndihmës akademik me përvojë <i>[Evidenca 36. CV e stafit ndihmës akademik; vizitë në institucion].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>UAMD i kushton një vëmendje të veçantë përmirësimit të bazës laboratorike. Me fond të institucionit janë bërë përmirësime të laboratorëve ekzistues dhe krijimi i një laboratorit të ri të elektronikës e cila do të mundësojë një përmirësim të praktikës së studentëve.</p> <p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni ka vepruar në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të paisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; - Së dyti, nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor; - Së treti, nëpërmjet krijimit të oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies; <p><i>[takime në institucion].</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë <i>[Ev. Evidenca 10. Personeli akademiki angazhuar në NJKTI; Evidenca 14. Liste MoU per publikim; Evidenca 32. Formular i vetëvlerësimit te performancës së personelit akademik; Evidenca 35 CV e stafit akademik].</i> Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët dhe nga rezultatet e pyetësorit të studentëve, rezulton se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit <i>[Ev. Takime në institucion; Evidenca 45. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)].</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe</p>	<p>DTI në bashkëpunim me NJSBC monitorojnë format e mësimdhënies të cilat janë objekt i diskutimeve dhe</p>

<p>përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>vlerësimeve nga studentët [Evidenca 44. Pyetësor Student UAMD; Evidenca 45. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)]. Rezultatet e pyetësorëve diskutohen në njësinë bazë dhe përmirësimet reflektohen në ndryshimet në përmbajtjen e syllabusit në masën 20%, në përmirësimin e orës mësimore duke e bërë më të kuptueshme për studentin [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UAMD ka ngritur struktura përgjegjëse që monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe promovojnë përmirësimin të vazhdueshme. GVJ konstaton një bashkërendim të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë detyrat përgjegjëse të cilës janë shprehur qartë në nenin 1 të Rregullores së NJSBC. Kjo drejtori organizon punën për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe shpërndarjes së pyetësorëve për studentët, administratën dhe stafin akademik, administron dokumentacione që lidhen me sigurimin e cilësisë, përpunon pyetësorët e vlerësimit të pedagogëve dhe asiston NJSBC duke siguruar informacione të vazhdueshme në lidhje me sigurimin e cilësisë [takim me përfaqësues të NJSBC-së].</p> <p>Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit i cili është përgjegjës për programin e studimit, dhe përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme dosjen e programit. DTI në bashkëpunim me NJSBC dhe koordinatorin e programit shqyrton me vëmendje rezultatet dhe mendimet e studentëve në lidhje me vlerësimin që kanë bërë për përmbajtjen e programit të studimit, stafin akademik dhe infrastrukturën dhe ndërmerr përmirësimet e duhura. Kërkesat për përmirësimet në bazën laboratorike, mjetet didaktike shqyrtohen në njësinë bazë dhe përmes hallkave të duhura dorëzohen tek Administratori i Institucionit. UAMD/DTI mbështet kualifikimet e stafit akademik përmes nxitjes së pjesëmarrjes së tyre në konferenca dhe trajnime [takim në institucion].</p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • DTI zbaton kuadrin ligjor në lidhje me format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive. • Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, ushtrimeve, detyrave të kursit, praktikës. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75-100%. Elementët e studimit janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare dhe provimi final. • GVJ konstaton se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë 	

program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë.

- UAMD ka ngritur struktura përgjegjëse që monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe promovojnë përmirësime të vazhdueshme. DTI në bashkëpunim me NJSBC monitorojnë format e mësimdhënies të cilat janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga studentët.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të vlerësimit të dijeve janë të shprehur në dokumentat bazë ku vlen të përmenden:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional 2 – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elektronike”, neni 17, dhe Kreu III, “Procedura dhe kritere vlerësimi”. Regullore e Njesisë Kryesore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit – neni 52 “Kontrolli i dijeve”; Rregullorja e IAL UAMD – Neni 68 “Kontrolli i dijeve”; <p><i>[Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit;]</i></p> <p>GVJ konstaton se kriteret e vlerësimit dhe mënyra e testimit janë përcaktuar qartë në rregulloret bazë dhe nga ana e DTI-së dhe stafit akademik evidenton një zbatim me korrektësi të procedurave të shprehura në këto rregullore <i>[vizitë në institucion]</i>.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Kriteret e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar në programin e lëndës dhe u bëhen të qartë studentëve që në fillim të semestrit akademik <i>[takim me studentët, takim me stafin akademik]</i>. Në syllabuse janë shprehur qartë forma e kontrollit të dijeve ku një rubrikë e veçantë i përket kriterit të vlerësimit në lidhje me frekuentimin dhe kontrollin e vazhdueshëm. Takimi me studentët konfirmon njohjen nga</p>

	<p>ana e tyre të përmbajtjes së syllabusit dhe vlerësimin me pikë për çdo formë të kontrollit të vazhdueshëm nga ana e pedagogut të lëndës <i>[takim me studentët]</i>.</p> <p>Vlerësimi për secilën lëndë mësimore bëhet përmes sistemit të notave nga 5 e cila është note kaluese deri në notën 10, ndërsa format e provimit përdorin sistemin e vlerësimit me 1000 pikë ku vlera përkatëse konvertohet në notë <i>[neni 23 në rregulloren e programit të studimit]</i>. Nota kaluese më e ulët që është 5 i korrespondon 51% të pikëve të fituara nga studenti. Provimi i parë i ndërmjetëm i theksuar në të gjithë syllabuset zhvillohet në javën e shtatë ose të tetë të semestrit ndërsa aprovimi i dytë zhvillohet në javën e 13-të. Detyrat e kursit që zhvillohen gjatë semestrit përmbajnë 100 pikë ose 10% të vlerësimit përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Institucioni përdor forma të miratuara në lidhje me testimin dhe vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit për çdo modul të programit të studimit. Regjistri i seksionit është një dokument bazë i cili përdoret nga stafi akademik për të dhënë temat e trajtuara dhe kohëzgjatjen e seksionit. Përmes tij pedagogu mat edhe frekuentimin e studentit në lëndë. Regjistri administrohet nga sekretaria mësimore. Testimi dhe vlerësimi i njohurive shprehen qartë në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuse. Forma e testimit është më shkrim. Mënyra e vlerësimit bëhet kryesisht me dy provime të cilët kanë përkatësisht një vlerësim me 400 pikë i pari dhe 500 pikë i dyti. Vlerësimi bëhet përgjatë semestrit dhe bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%) <p><i>[Evidenca 21_ Syllabuset e lëndëve), Evidenca 26_Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e sistemit të vlerësimit të studentëve].</i></p> <p><i><u>GVJ sugjeron që të konsiderohet edhe elementi i aktivizimit në auditor në vlerësimin e studentit.</u></i></p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kriteret dhe mënyra e testimit të vlerësimit të dijeve janë të shprehur në dokumentat bazë, gjithashtu janë të përcaktuar në programin e lëndës.</i> • <i>Në syllabuse janë shprehur qartë forma e kontrollit të dijeve ku një rubrikë e veçantë i përket kriterit të vlerësimit në lidhje me frekuentimin dhe kontrollin e vazhdueshëm.</i> 	

- *Institucioni përdor forma të miratuara në lidhje me testimin dhe vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit për çdo modul të programit të studimit.*
- *GVJ sugjeron që të konsiderohet edhe elementi i aktivizimit në auditor në vlerësimin e studentit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se, për programin e studimit 2 –vjeçar me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike” kontrolli dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë semestrit (15 javë) dhe mbyllet me provimin përfundimtar, pesha e të cilit në vlerësimin e përgjithshëm është 50%. Elementët e tjerë që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të lëndës janë provimi i pjesshëm (me një peshë që varion nga 40%) dhe vlerësimi që lidhet me detyrimet e tjerë siç janë detyrat e kursit, projekti (me një peshë që varion nga 10%) [Evidenca 21. Syllabust e kurseve (te firmosura)]. Në syllabuse nuk janë shprehur edhe vlerësimi i studentit në orët e ushtrimeve dhe orët laboratorike.</p> <p><i>GVJ rekomandon përfshirjen e tyre në sistemin e vlerësimit të studentit.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>UAMD ka një marrëveshje bashkëpunimi si pjesë e projektit Clean Score të mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Çdo personel akademik i FTI që ka dëshirë të realizojë vlerësimin elektronik të provimeve e ka mundësinë për ta aplikuar këtë metodë si pjesë e këtij bashkëpunimi.</p> <p>GVJ nuk konstaton zbatimin e tij në këtë program studimit.</p> <p>UAMD përdor edhe platformën PITAGORA për hedhjen e notave dhe njohjen e vlerësimit nga ana e studentit [takim në institucion].</p>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe në përputhje me nenet përkatëse të shprehur

<p>përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>në Rregulloren e IAL UAMD për vlerësimin e dijeve të studentit dhe format e kontrollit nga ana e stafit akademik. [Evidenca 21. Syllabust e kurseve (te firmosura); Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 23. Rregullorja e programit; Evidenca 7. Rregullore NJKTI;]</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive shprehet qartë në syllabusin e lëndës. GVJ konstaton dy provime të ndërmjetme në shumicën e lëndëve të programit të studimit. Vlerësimi në provimin e ndërmjetëm është në total me 400 pikë. Në fund të çdo provimi pedagogu është i gatshëm të zhvillojë me studentët një seancë për të dhënë zgjidhjet përkatëse dhe të diskutojë problematikat e gjetura. GVJ konstaton një uniformitet të vlerësimit të dijeve në të gjithë lëndët.</p> <p><i>GVJ sugjeron që format e kontrollit të jenë të variueshme në varësi të diversitetit që çdo lëndë përmban.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Rregulloret bazë përcaktojnë qartë penalitetet në lidhje me kopjimin në provime dhe detyra kursi. Kodi i Etikës është një rubrikë e veçantë e shprehur në çdo syllabus [Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit; Evidenca 29. Kodi Etikës UAMD.; Evidenca 21. Syllabust e kurseve (te firmosura);]</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga diskutimet me lektorë dhe studentë të programit të studimit GVJ konstatoi se rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen mbi meritën, i korrespondojnë një vlerësimi të shtrirë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës duke reflektuar gjithë komponentët e formimit [Ev. Takime në institucion]. Gjithashtu, u konstatua se rezultatet jepen në kohë, bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se dokumentat bazë institucionale sanksionojnë të drejtat e studentit për njohjen e vlerësimit të tij, të drejtën e rishikimit të vlerësimit dhe të ankimimit të studentëve [takim ne institucion].</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe</p>	<p>Neni 71 në Rregulloren e UAMD-së përcakton qartë të drejtën e studentit për ankimin. Ankesa i drejtohet me shkrim drejtuesit të FTI-së dhe dhe jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve. Në takimin e zhvilluar në institucion me studentët GVJ nuk u njoh me raste ankimimi nga ana e tyre.</p>

arkivohet.

Konkluzione

- Bazuar në syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se, për programin e studimit 2 –vjeçar me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike” kontrolli dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë semestrit (15 javë) dhe mbyllet me provimin përfundimtar, pësha e të cilit në vlerësimin e përgjithshëm është 50%.
- Në syllabuse nuk janë shprehur edhe vlerësimi i studentit në orët e ushtrimeve dhe orët laboratorike. GVJ rekomandon përfshirjen e tyre në sistemin e vlerësimit të studentit.
- UAMD përdor edhe platformën PITAGORA për hedhjen e notave dhe njohjen e vlerësimit nga ana e studentit.
- Rregulloret bazë përcaktojnë qartë penalitetet në lidhje me kopjimin në provime dhe detyra kursi.
- GVJ konstaton se dokumentat bazë institucionale sanksionojnë të drejtat e studentit për njohjen e vlerësimit të tij, të drejtën e rishikimit të vlerësimit dhe të ankimimit të studentëve.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit dy – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” mundëson thellimin e njohurive në fushën e elektronikës dhe aftësive profesionale si:</p> <ul style="list-style-type: none">• Mirëmbajtës dhe riparues të pajisjeve kompjuterike (kompjuterat personalë të të gjitha tipeve, monitorë, printera, skanera, fotokopje, ploter etj);• Mirëmbajtës dhe riparues sistemesh sigurie dhe monitorimi (sisteme video, sisteme alarmi, sisteme mbrojtjeje nga zjarri etj);• Mirëmbajtës dhe riparues të pajisjeve mobile (smartphone, tablet, minikompjuter, sisteme GPS etj);• Mirëmbajtës dhe riparues të pajisjeve elektronike

	<p>(karikues, blloqe ushqimi, konvertues, chipsete etj);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mirëmbajtës dhe konfigurues të paketave të programeve kompjuterike (Ëindoës, Microsoft Office, Adobe, Autodesk etj); • Mirëmbajtës rrjetesh kompjuterike; • Mirëmbajtës pajisjesh POS (Point of Sale); • Operator në sistemet back-end të kompanive të biznesit; <p>[Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit].</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> se në mënyrën e zhvillimit të programit të studimit integrimi i orëve laboratorike dhe praktika mësimore është një domosdoshmëri e cila do të ndikojë në zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve në fushën e aplikimeve të teknologjisë elektronike dhe kompjuterike.</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> se rishikimi i ngarkesës së programit mësimor përmes dhënies së peshës së duhur lëndëve detyruese do të mundësojë studentët të thellojnë njohuritë e tyre si në fushën teorike ashtu edhe praktikë.</p> <p>[Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit; Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit; Evidenca 21. Syllabuset e kurseve]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit dy – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është i fokusuar vetëm në fushën e elektronikës Në kategorinë “C”- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese janë konsideruar si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mirëmbajtje pajisjesh IT; 2. Diagnostifikimi i sistemeve elektronike; 3. E drejta kibernetike; 4. Editimi i skemave elektrike; 5. Montimi i kompjuterit personal; 6. Qarqet e kontrollit; 7. Elektronika industrial; 8. Bazat e Telekomunikacionit; 9. Mirëmbajtje pajisjesh IT; 10. Diagnostifikimi i sistemeve elektronike;

	<p>GVJ konstaton që për vitin 2022-2023 është aktivizuar lënda me zgjedhje “E drejta kibernetike” (viti I- semestri I) duke i dhënë mundësi studentit të aftësohet edhe në kuadrin ligjor për këtë aspect.</p> <p><i>[ev: Tabela Permbledhese per programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike; Evidenca 18. Plani mesimor i programit te studimit;].</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton një bashkëveprim të DTI-së me stafi akademik në lidhje me analizimin dhe shqyrtimin e problematikave të shprehur nga studentët në pyestorët e plotësuar nga ana e tyre për çdo lëndë dhe vlerësimin e bërë për stafin akademik dhe infrastrukturën. Diskutime mbahen në njësinë bazë dhe hapa në lidhje me përmirësimet bëhen në këtë drejtim <i>[takim në institucion]</i>.</p> <p>Në fund të çdo provimi të ndërmjetëm shikohet progresi i studentëve dhe çështjet e trajtuara në provim trajtohen edhe njëherë nga stafi akademik <i>[takim me stafin akademik]</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Një nga objektivat formues të programit të studimit është aftësimi praktik i studentëve në përfundim të studimeve të tyre. GVJ shqyrtoi edhe dokumentacionin e paraqitur nga institucioni në hapjen e programit të studimit. Në të evidentohen edhe rekomandimet e dhëna nga grupi i ekspertëve të vlerësimit në hapjen e programit të studimit ku veçojmë dy çështje bazë si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Vendosja e praktikës profesionale 6-12 ECTS në programin e studimit;</i> 2. <i>Përmirësimi i kushteve laboratorike;</i> <p>Për sa më sipër GVJ rithekson edhe njëherë domosdoshmërinë e zhvillimit të praktikës profesionale si një mundësi që forcon një set kompetencash të studentit në këtë fushë.</p> <p>GVJ rithekson edhe ndarjen në planin mesimor të orëve laboratorike, paraqitjen e tematikave të tyre, orët e ushtrimeve dhe pjesës teorike (leksione) ku prevalenca të jetë në fushën e praktikës (të paktën të arrihet raporti 50%:50% ose të tejkalohet në drejtim të praktikës).</p> <p>Ndonëse në këtë kriter theksohet “.Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale”, GVJ nuk gjen evidence dhe deshmi te</p>

	kompetencave të fituara nga studenti në aspektin laboratorik dhe praktikës profesionale [Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit] pasi GVJ nuk gjet dëshmi në lidhje me tematikën e orëve laboratorike të trajtuar nga ana e stafit akademik.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ u informua se NJKFTI organizon edhe leksione të hapura, trajnime dhe orë informuese në bashkëpunim edhe me zyrën e Komunikimit, Karrierës & Alumni [takime në institucion].

Konkluzione

- Programi i studimit dy – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” mundëson thellimin e njohurive në fushën e elektronikës dhe aftësive profesionale.
- GVJ konstaton një bashkëveprim të DTI-së me stafin akademik në lidhje me analizimin dhe shqyrtimin e problematikave të shprehur nga studentët në pyestorët e plotësuar nga ana e tyre.
- Një nga objektivat formues të programit të studimit është aftësimi praktik i studentëve në përfundim të studimeve të tyre.
- Bazuar edhe në rekomandimet e dhëna nga grupi i ekspertëve të vlerësimit në hapjen e programit të studimit GVJ rithekson edhe njëherë domosdoshmërinë:
 1. zhvillimit të praktikës profesionale si një mundësi që forcon një set kompetencash të studentit në këtë fushë;
 2. ndarjen në planin mësimor të orëve laboratorike, paraqitjen e tematikave të tyre, orët e ushtrimeve dhe pjesës teorike (leksione) ku prevalenca të jetë në fushën e praktikës;

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblylëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato	GVJ konstaton se rregulloret bazë të UAMD/FTI/DTI dhe programit të studimit përmbajnë informacion të veçantë në lidhje me detyrimet përmblylëse. Sekretaria mësimore

publike.	përcakton qartë nëse studenti i ka mbyllur të gjithë lëndët e programit të studimit, detyrimet financiare duke i dhënë mundësi atij të hyje në provimin final <i>[Evidenca 7_Rregullore e NjKTI, Neni 59-62; Evidenca 6_Rregullore e UAMD; Neni 76-79, vizitë në sekretarinë mësimore]</i> .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ konstaton angazhim të stafit akademik në drejtim të shpërndarjes së informacionit në lidhje me provimet, dhe detyrimet përmbyllëse. Çdo pedagog në fillim të lëndës i vë në dispozicion studentit syllabusin ku janë përcaktuar qartë edhe detyrimet që ai ka për të plotësuar në lidhje me modulën <i>[takim me stafin akademik; takim me studentët]</i> . DTI vë në dispozicion të studentëve një listë të pyetjeve të provimit përfundimtar. Aktualisht nga të dhënat statistikore rezultojnë vetëm 1 student i diplomuar.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Rregullorja e NjKFTI-së përmban në nenin 62 të drejtat e organizimit të provimit përfundimtar. GVJ në takimin e zhvilluar në institucion mori informacion në këtë drejtim dhe konkludojmë se DTI zbaton me korrektësi procedurën e provimit përfundimtar.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ konstaton në programin mësimor si detyrim përmbyllës me 6 ECTS provimin përfundimtar <i>[Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit]</i> .
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Nuk është e aplikueshme.
Kriteri 6. Në përfundim të	Në përfundim të detyrimit përmbyllës studenti vlerësohet me

detyrimet përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	pike nga komisioni të cilat konvertohet në notë <i>[takim ne institucion; Evidenca 7_Rregullore e NjKTI, Neni 61, 62]</i> . Rezultati përfundimtar regjistrohet dhe bëhet publik.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomë Profesionale dhe me Suplementin e Diplomës dhe një kopje e plote zyrtare e programit të zhvillimit i vihet në dispozicion <i>[Evidenca 20. Suplementi i diplomës]</i> . GVJ ndër morri edhe një vizitë në sekretarinë mësimore dhe konstatoi se Regjistri i lëshimit të diplomave mungon në këtë sektor. Ndonëse Institucioni ka bërë komunikime të vazhdueshme me QSHA-në për pajisjen me këtë regjister nga ana e kësaj të fundit akoma nuk është bërë e mundur vënia në dispozicion [vizite në sekretarinë mësimore]. GVJ konstatoi gjatë vizitës edhe një format të Suplementin të Diplomës të lëshuar për këtë program studimi <i>[vizitë në sekretarinë mësimore]</i> .
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UAMD përmes sekretarisë mësimore ruan të dhënat në lidhje me studentët. Dosjet personale të tyre arshivohen dhe ruhen. Në lidhje me ecurinë dhe progresin e tyre mungesa e Regjistrit Themeltar, Regjistrin të Notave dhe të Diplomës bën që informacioni zyrtar të mungojë. Nga ana e përfaqësuesve të kësaj zyre u theksua mbajtja e të dhenave në formë elektronikë dhe në hard copy. <i>GVJ rekomandon pajisjen e Sekretarisë Mësimore me regjistrat bazë të cilët do të sigurojnë ruajtjen e një informacioni zyrtar në lidhje me çdo student në veçanti dhe për programin në tërësinë e tij.</i>
Konkluzione <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ konstaton se rregulloret bazë të UAMD/FTI/DTI dhe programit të studimit përmbajnë informacion të veçantë në lidhje me detyrimet përmbyllese.</i> • <i>GVJ konstaton angazhim të stafit akademik në drejtim të shpërndarjes së informacionit në lidhje me provimet, dhe detyrimet përmbyllese.</i> • <i>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomë Profesionale dhe me Suplementin e Diplomës dhe një kopje e plote zyrtare e programit të zhvillimit i vihet në dispozicion.</i> • <i>GVJ konstaton mungesë të Regjistrin Themeltar, të Regjistrin të Notave dhe Diplomës duke bërë që informacioni zyrtar të mungojë. GVJ rekomandon pajisjen e Sekretarisë Mësimore me regjistrat bazë të cilët do të sigurojnë ruajtjen e një informacioni zyrtar në lidhje me çdo student në veçanti dhe për programin në tërësinë e tij.</i> 	
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD nuk ka një udhëzues të veçantë në lidhje me zhvillimin e metodave të mësimdhënies. GVJ është njohur me mënyrën e mësimdhënies të ndjekur nga FTI ku përfshihet edhe ky program studimi për leksionet e integruara me seminarin të cilën stafi akademik e konsideron shumë pozitiv dhe që ofron një fleksibilitet në shtjellimin e temave teorike dhe kombinimit të tyre me shembuj pratike.</p> <p>Për zhvillimin e orëve mësimore gjatë situatës së covid-19, stafi akademik përshtati edhe metodat e mësimdhënies. Leksionet dhe seminarët u zhvilluan përmes powerpoint dhe ilustrime praktike me video dominonin në këtë periudhë <i>[takim me stafin akademik]</i>.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ u njoh me punën e zhvilluar nga Sektori i çështjeve mësimore dhe Sektori i Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë pranë UAMD-së në lidhje me zhvillimin e pyetsorëve tek studentët dhe përpunimin e të dhënave. Në takimet e zhvilluar në institucion shumë pyetje u zhvilluan në lidhje me monitorimin e programit mësimor duke konsideruar gërshetimin e leksionit më orët e ushtrimeve. DTI nuk zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të procesit të mësimdhënies nga ana e stafit akademik <i>[takim në institucion]</i>.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni/DTI duhet të ofrojë forma dhe metoda të matjes së aftësisë mësimdhënëse të stafit akademik [takim me drejtues të DTI-se].</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ u njoh me mënyrën e hartimit të pyetsorëve dhe përpunimit të të dhënave përmes lexuesit optik i ofruar në kuadër të një projekti të UAMD-së. Rezultatet në lidhje me infrastrukturën dhe përmbajtjen e programit mësimor bëhen të njohura në department dhe diskutohen në mbledhje ndërsa rezultatet në lidhje me vlerësimin e stafit akademik shpërndahen në mënyrë individuale dhe i bëhen të ditur edhe</p>

	drejtuesit të DTI-së. Problematikat diskutohen dhe reflektohen edhe në raportet vjetore [takim me NJSBC-në, takim më stafin akademik].
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UAMD përmes NJSBC monitoron personelin akademik në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor. GVJ nuk gjeti evidence në lidhje me pasqyrimin e praktikave më të mira në këtë drejtim. UAMD inkurajon stafin akademik të marre pjesë në trajnime, konferenca dhe përmes programit Tempus dhe Erasmus+ FTI/DTI ka pasur mobilitet të stafit akademik (incoming dhe outgoing).

Konkluzione

- *GVJ konstaton se UAMD nuk ka një udhëzues të veçantë në lidhje me zhvillimin e metodave të mësimdhënies.*
- *DTI nuk zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të procesit të mësimdhënies nga ana e stafit akademik.*
- *UAMD përmes NJSBC monitoron personelin akademik në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor.*
- *UAMD inkurajon stafin akademik të marre pjesë në trajnime, konferenca dhe përmes programit Tempus dhe Erasmus+ FTI/DTI ka pasur mobilitet të stafit akademik (incoming dhe outgoing).*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik	GVJ konstaton një angazhim të stafit akademik me

dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

eksperiencë dhe me grada shkencore në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për ofrimin e programeve mësimore në Republikën e Shqipërisë [Evidenca 14. Liste MoU për publikim; evidence: CV të stafit akademik].

Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Referuar tabelës përmbledhëse, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përse i përket kualifikimit. Konkretisht për këtë program studimi janë angazhuar:

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	1	-	2	-	1	-
Dr/PhD	6	-	5	-	6	-
Msc	6	-	6	-	7	-
Në total	13	0	13	0	14	0

Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor [evidencë nr.35: CV e stafit akademik; Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike, tab 6.1-6.3].

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik mbulon programin mësimor me një ngarkesë mësimore e cila nuk tejkalon ngarkesën e përcaktuar nga MASH për ngarkesën mësimore të personelit akademik. Siç është specifikuar edhe në tabelën e dhënë më sipër, në kriterin 1, për këtë program mësimor është angazhuar një staf akademik ku mbizotëron grada shkencore Dr dhe Dr në proces.

Nga tabela e ngarkesave e paraqitur nga institucioni konstatojmë se personeli akademik ne DTI secili angazhohet në katër module për të gjithë programet mësimore duke ofruar në total një ngarkesë 3150 orë në semestrin e I-rë, 1734 orë në semestrin e II-të (total 4884 orë) dhe mbulon 2506 orë suplementare. Në lidhje me stafin akademik (PAE) me graden shkencore MSc, GVJ konstaton mbingarkese e

	<p>cila ndonëse është në kufijtë e lejuar dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe të normave të vendosura nga VKM në fuqi për mbingarkesën në këtë kategori lektorësh, përsëri përbën një pengesë për përparimin e tyre me grada më të larta shkencore.</p> <p><i>[Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike; Evidenca 38. Ngarkesa mësimore e stafit akademik NJBTI; Evidenca 40. Tabela e stafit të angazhuar në programin e studimit;]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni paraqet stabilitet në lidhje me ruajtjen e personelit akademik për këtë program studimi. UAMD si IAL publike i nënshtrohet të gjithë kuadrin ligjor në fuqi në lidhje me kontratat e punësimit, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe zbatimin e të gjithë rregullave për një punësim korrekt të stafit akademik, Personelit ndihmës dhe stafit administrativ. UAMD si institucion publik i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm (MASH, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektorati i Punës dhe institucionet shtetërore financiare) <i>[Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike; vizitë në zyrën e Burimeve Njerëzore, takim me stafin akaddemik].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në UAMD bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve ligjore dhe nënligjore të shprehur në Statut dhe në Rregulloret përkatëse. Institucioni garanton zbatimin e procedurave të qarta në lidhje me rekrutimin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë. Në praktikën e tij FTI merr të gjitha masat që në procesin e rekrutimit të punësojë ekspertë që i përshtaten programeve të ofruara të studimit. Në përzgjedhjen e kandidatit në mënyrë specifike vlerësohen edukimi/kualifikimi, kërkimi shkencor dhe eksperiencia profesionale <i>[takim në institucion; vizitë në zyrën e Burimeve Njerëzore; Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike;].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p>UAMD/FTI/DTI garantojnë angazhimin e një personeli ndihmës akademik (2 në total) në mbështetje të programit mësimor. Kryesisht personeli ndihmes akademik është i përfshirë në laboratorë, në dhenien e asistencës së personelit akademik gjatë procesit mësimor dhe mbikqyrjen e studentëve gjatë orëve laboratorike. GVJ u njoh edhe me CV</p>

<p>mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>e stafit ndihmës akademik dhe konstaton se ata kanë një eksperiencë në këtë fushe dhe diplomuar në fushen e inxhinerisë IT <i>[evidence 36: stafi ndihmës akademik]</i>. GVJ gjatë vizitës në institucion u njoh me laboratorët dhe stafin e përfshirë dhe vëren një gadishmëri nga ana e tyre në ndihmë të studentëve <i>[vizitë në institucion]</i>.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>UAMD si institucion publik iarsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohet të gjithë rregullave dhe procedurave ligjore në lidhje me angazhimin e stafit akademik dhe ngarkesës mësimore. DTI është përgjegjës për monitorimin e personelit akademik në programin mesimor dhe matjen e ecurisë së programit në nivel semestral dhe vjetor. Në fund të çdo viti akademik personeli përcakton ngarkesën mësimore faktike e cila miratohet më pas nga përgjegjesi i departamentit të DTI-së. DTI është përgjegjës për hartimin e parashikimeve në lidhje me ngarkesën mësimore dhe kërkesën për lektorë të ftuar e cila vijon më pas me miratimet në instancat përkatëse të UAMD-së <i>[vizitë në institucion, takim me stafin akademik, takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore; evidencë 40: tabela e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; evidencë 38: ngarkesa mësimore e stafit akademik; evidencë 37: Memo analiza vjetore update 20-21]</i>.</p> <p>UAMD ka krijuar edhe Drejtorinë Mësimore e cila ruan të gjithë informacionin mësimor në lidhje me programin e studimit dhe personelin akademik të angazhuar. Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit në lidhje me personelin akademik me kohë të plote dhe të pjesshëm. Në takimin e zhvilluar u konstatua se kjo drejtori nuk angazhohet me monitorimin e ngarkesës mësimore por është përgjegjëse për personelin akaddemik në programin mësimor <i>[takim me zyrën e Burimeve Njerëzore]</i>.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së</p>	<p>UAMD ka në fokus të Strategjisë së Zhvillimit edhe rritjen e bashkëpunimit me institucione të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunime me kompani kryesisht në rrethin e Durrësit dhe të Tiranës. GVJ u njoh me një listë të bashkëpunimeve në këtë kuadër <i>[evidence 13: marrëveshjet e nënshkruara në vitet 2021-2022]</i>.</p> <p>Programi i studimit 2- vjeçar me karakter profesional nuk ka të përfshirë praktikën profesionale dhe GVJ nuk mund të japë mendim në lidhje me stafin akademik të përfshirë në këtë proces sic kërkohet edhe në këtë kriter.</p>

programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se UAMD ka tashmë të ngritur një strukturë bashkëpunimi në mbështetje të praktikës profesionale. GVJ rithekson përfshirjen e praktikës profesionale në programin e studimit pasi tashmë bashkëpunimet me kompanitë e biznesit janë të vendosura dhe zhvillimi i saj do të sjellë një aftësim më të mirë praktik të studentëve por edhe do të perthithe mendimin e përfaqësuesve të biznesit në lidhje me përmirësimet në përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>[Evidenca 18. Plani mësimor i programit të studimit]</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Programi i studimit nuk ka të përfshirë në përmbajtjen e tij praktikën profesionale. GVJ nuk mund të japë mendim në lidhje me këtë kriter <i>[Evidenca 18. Plani mësimor i programit të studimit]</i>.</p>			
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ konstaton një angazhim të stafit akademik me eksperiencë dhe me grada shkencore në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për ofrimin e programeve mësimore në Republikën e Shqipërisë.</i> • <i>Programi mësimor mbulohet vetëm nga staf akademik efektiv (PAE). Personeli akademik mbulon programin mësimor me një ngarkesë mësimore e cila nuk tejkalon mbingarkesën e përcaktuar nga MASH.</i> • <i>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në UAMD bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë.</i> • <i>DTI është përgjegjës për monitorimin e personelit akademik në programin mesimor dhe matjen e ecurisë së programit në nivel semestral dhe vjetor.</i> • <i>Programi i studimit nuk ka të përfshirë në përmbajtjen e tij praktikën profesionale. GVJ nuk mund të japë mendim në lidhje me kriterin 7 dhe 8 të standartit IV.1.</i> 				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e

përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional 2 – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elektronike” zhvillohet në ambjentet e ndërtesës e vendosur ne zonën e Currilave në Durrës. UAMD për këtë program studimi ka vënë në dispozicion klasa për seminare dhe leksione të cilat janë konform standarteve për zhvillimin e një procesi mësimor të duhur. Ambjentet janë të ndriçuara, të pajisura me mjetet e duhura didaktike <i>[vizitë në institucion; Evidenca 41. foto nga labororet].</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset në të cilat zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit përmbushin më së miri standartet dhe janë në raport të drejtë me numrin e stafit akademik dhe të studentëve të programit. Auditorët, zyrat, laboratorët janë të ndriçuara drejt dhe të pajisura me të gjithë mjetet didaktike që mundësojnë një zhvillim normal të procesit mësimor <i>[vizitë në institucion; Evidenca 41. foto nga labororet].</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit me karakter profesional 2 – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elektronike”, FTI/DTI ka vënë në dispozicion 2 laboratorë të profilit multimedia si edhe një laborator kërkimor të cilet janë të pajisur me të gjithë mjetet didaktike për një zhvillim brenda standarteve të orëve laboratorike. Në takimet e zhvilluara GVJ u njoh nga stafi akademik që shumë nga temat laboratorike janë zhvilluar edhe përmes ilustrimeve me video. Në këtë drejtim ka shërbyer laboratorin e simulimit të pajisjeve elektronike (MULTISIM).</p> <p>GVJ në vizitën në institucion u njoh edhe me pajisjet e reja për laboratorin e elektronikës <i>[evidence: liste e pajisjeve të laboratorit të elektronikës].</i> Rëndësia e këtij laboratorin ka qene e madhe dhe nga ana e stafit është kërkuar investime në këtë drejtim. Pasurimi i bazës laboratorike ka qenë edhe rekomandim i shprehur nga grupi i vlerësimit gjatë hapjes së programit të studimit <i>[Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes së programit të studimit].</i> Theksojmë që institucioni vetëm në vitin 2022-2023 kreu investime në këtë drejtim. Investimi në laboratorin e ri të Elektronikës është bërë me fondet e Institucionit dhe do të plotësojë kërkesat për lëndët si vijon</p>

	<p>më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Bazat e elektroteknikës; b. Elektronike 1; c. Elektronike 2; d. Sensorë dhe shndërrues; e. Matjet elektrike dhe elektronike; f. Qarqet e Kontrollit; g. Skema elektrike; h. Editimi i skemave elektrike; <p>Ky laborator përmban student kit (për 10 studente/ një grup) për të përmbushur temat kryesore në këto lëndë. Ky laborator zotëron edhe pajisja me minipanele fotovoltaike (10 copë), 2 minipanele+ inverter për fotovoltaike hybrid solar e cila do te përdoret për ndriçimin e stendave kryesore të godines dhe do te jetë një konkretizim i punës së studentëve në këtë fushë.</p> <p>GVJ konsideron që ky laborator nuk është përfshirë në RVB por vizita në institucion demonstroi pajisjet e reja që tashmë janë duke marrë dhe po punohet për instalimet e tyre ne ambjentet e duhura.</p> <p>GVJ gjithsesi në lidhje me vlerësimin përgjate këtyre viteve të programit, thekson dobësinë e institucionit në lidhje me aftësimin praktik të studentëve në këtë drejtim. <i>GVJ mendon që mungesa e një baze të duhur laboratorike ka sjellë edhe mospërgatjen e duhur të studentëve në këtë fushë ndonëse nuk mund të arrijmë në konkluzione për shkak të mungesës së evidencave në këtë drejtim.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ thekson punën që duhet të bëjë akoma institucioni për pasurimin e bazës laboratorike. Përmirësimi i laboratorit të elektronikës duhet të jetë në vazhdimësi dhe në përmbushje të të gjithë tematikave të praktikës për modulet në këtë program studimi. GVJ thekson qe pasurimi i tij do të kontribuojë në përmbushjen e duhur të kriterit 50:50 (teori kundrejt praktikës).</p>
<p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Programi i studimit me karakter profesional 2 – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elektronike” zhvillohet në ambjentet e ndërtesës e vendosur ne zonën e Currilave në Durrës. Mjediset në të cilat zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit përmbushin më së miri standartet dhe janë në raport të drejtë me numrin e stafit</i> 	

akademik dhe të studentëve të programit.

- Për programin e studimit me karakter profesional 2 – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elektronike”, FTI/DTI ka vënë në dispozicion 2 laboratorë të profilit multimedia si edhe një laborator kërkimor.
- Në shërbim të moduleve institucioni për vitin 2023 ka investuar në krijimin e laboratorit të elektronikës. GVJ thekson rëndësinë e tij për aftësimin praktik të studentëve dhe konstaton mungesën e gjatë të tij për tre vitet akademike ndonëse ka qenë edhe rekomandim i shprehur nga grupi i vlerësimit në hapjen e programit të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ u njoh me përmbajtjen e syllabuseve dhe literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Për lëndët në këtë program studimi janë hartuar cikël leksionesh nga secili Lektor si literaturë e detyruar e cila u vihet në dispozicion të studentëve në fillim të semestrit ndërsa literatura e rekomanduar është kryesisht e dhjetë viteve të fundit dhe në gjuhën angleze. Fondi i bibliotekës vihet në dispozicion të studentëve për materiale ndihmëse shtesë. Leksionet mund të merren në hard copy ose në forme dixhitale. Kopjet fizike të leksioneve të lëndëve të këtij programi studimi, depozitohen në DTI dhe në Bibliotekën e UAMD. <i>[takim ne institucion, vizitë në bibliotekë, Evidenca 21. Syllabuset e kurseve (të firmosura)]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UMAD ka vënë në dispozicion bibliotekën e vendosur në katin e parë të godines në zonen e Currilave. Biblioteka është e hapur edhe gjatë fundjavës në shërbim të studentëve. Biblioteka ka në fondin e saj 8000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj në format letër dhe elektronik. Biblioteka funksionon mbi bazën e një rregullore dhe ka në shërbim të saj edhe dy biblioteka përkatësisht në Godinen 1 dhe në Kampus <i>[vizitë në bibliotekë; Evidenca 49. Rregullorja e bibliotekës].</i>

<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ehste e pajisur me tekste mesimore per stundetet ne kete program studimi. Numri i kopjeve per cdo titull varion 2-5 kopje ndersa kopjet e librit te huaj 1-2. Studentët kanë mundësinë të konsultojnë librat (të fondit fizik të saj) në ambientin e bibliotekës, ose të shfrytëzojnë on-line pakufizim bibliotekën shumë të gjerë virtuale. Kontigjenti i librave ka ardhur nga blerjet, dhurimet nga IAL, Shtëpi botuese, etj, si edhe nga projektet të ndryshme (IZUM- përfshirja në rrjetin COBISS, akses falas në U-LIBRARY, lidhja me BK, Lidhja me kompaninë Koral INC, etj) <i>[vizitë në bibliotekë]</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se biblioteka e ofron shërbimin e saj pa pagesë si për studentët ashtu edhe për personelin akademik. Bazuar edhe ne mbështetjen e IFLAs, është instaluar Katalogu Online i Integruar për menaxhimin e fondit të saj <i>[vizitë në bibliotekë]</i>.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Në ambjentet e bibliotekës janë të instaluar PC me programe te përshtatshme të cilat u mundësojnë studentëve të kenë akses në literaturën fizike dhe akses në bibliotekë online. Në kompjuterat e saj janë instaluar programe specifike sipas disiplinave të studimit. Salla me fond të hapur ofron;</p> <ol style="list-style-type: none"> a. <i>Literaturë referenciale;</i> b. <i>Periodikun;</i> c. <i>Literaturë print;</i> d. <i>Literaturë prej burimeve elektronike të huaja;</i> e. <i>Akses në internet; [vizitë në bibliotekë].</i>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit. Salla me fond të hapur është komode dhe në shërbim të plote të studentëve, personelit akademik etj, çdo ditë të javës nga ora 8.00-16.00.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin,</p>	<p>GVJ konstaton që UAMD ndjek një procedure të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Ndonëse në RVB është theksuar që alokimi i fondeve për pasurimin e bibliotekës nuk janë në mënyre periodike, GVJ konstaton se nga nga ana e institucionit ne mënyre të vazhdueshme bëhen procedura prokurimi për fondin e bibliotekës bazuar mbi kërkesat që burojnë nga stafi akademik ku përfshihet edhe ai i</p>

shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	DTI-së. [vizitë në bibliotekë, takim me stafin akademik].
--	---

Konkluzione

GVJ konstaton se UAMD ka ngritur tre biblioteka në shërbim të studentëve. Fondi i bibliotekës është i konsiderueshëm. Biblioteka siguron ambiente të duhura për studentët. GVJ vëren si literaturë të detyruar ciklin e leksioneve të hartuar nga Lektorët përgjegjës të lëndës dhe literaturë të rekomanduar e gjen të dhjete viteve të fundit dhe kryesisht në gjuhën angleze. GVJ konstaton që UAMD ndjek një procedurë të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të miratuar.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	<p>UAMD ka ngritur një sistem të menaxhimit të informacionit. Rregulloret bazë përcaktojnë qartë veprimtarinë e çdo strukture e cila ka në përgjegjësi menaxhimin e të dhënave në lidhje me studentët dhe progresin e tyre gjatë vitit akademik deri në përfundim të studimeve. [Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD.; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit].</p> <p>Bazuar edhe në Statut (neni 92), UAMD mban në forme të shkruar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rregjistrin themeltar të studenteve; Rregjistrin e arritjeve akademike; Rregjistrimin e lëshimit të diplomave dhe

	<p style="text-align: center;"><i>çertifikatave;</i></p> <p>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Në vizitën e zhvilluar në institucion, nga GVJ u konstatua se për programin e studimit 2 – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike”, nga punonjëset e Sekretarisë Mësimore nuk disponoheshin: Regjistri Themeltar, Regjistri i Arritjeve Akademike dhe Regjistri i Lëshimit të Diplomave.</p> <p>Në nenin 92, në Statut të UAMD-së pika 2 citojmë: “<i>UAMD pajiset me rregjistrat që shperndan ministria përgjegjëse për arsimin dhe kundrejt tarifës përkatëse sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave</i>”. Ndonëse nga ana e institucionit në mënyrë të vazhdueshme janë bërë kërkesa në formë ligjore për pajisjen e tyre nga ana e QSHA-së, përsëri për këtë program këto dokumenta baze mungojnë. GVJ nuk pati mundësinë të verifikonte edhe pajisjen e studentëve me numër matrikulimi siç përcaktohet qarte edhe në nenin 92 në Statut të UAMD-së. Ndonëse nga ana e Sekretarisë Mësimore, GVJ konstaton mbajtjen e të dhënave në formë hard copy në disa regjistra të krijuar nga ana e tyre apo edhe në formë elektronike, përsëri GVJ konsideron mungesën e rregjistrave ligjore nga ana e Institucionit. Sekretaria mësimore administron edhe regjistrin e kursit i cili plotësohet çdo ditë nga stafi akademik në lidhje me temat e zhvilluara dhe frekuentimi i ndjekur nga studentët [<i>takim në sekretarinë mësimore, evidencë shitesë; komunikimi me QSHA për pajisjen me rregjistra</i>].</p> <p><i>GVJ rekomandon pajisjen e Sekretarisë Mësimore me regjistrat bazë të cilët do të sigurojnë ruajtjen e një informacioni zyrtar në lidhje me çdo student në veçanti dhe për programin në tërësinë e tij.</i></p> <p>Për menaxhimin e informatizuar të informacionit në UAMD është zhvilluar një sistem i emërtuar Pitagora i cili është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i UAMD-së [<i>Ev. RVB; Vizitë në institucion;</i>].</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit</p>	<p>Sistemi i informacionit i UAMD-së, Pitagora, synon të kontribuojë në menaxhimin e institucionit. Pitagora është një sistem efektiv për personelin akademik që krijon lehtësi të stafit akademik në: në hedhjen e notave, ndjekjen e frekuentimin si dhe ofron akses për studentët të cilët</p>

<p>administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>lehtësisht marrin në kohe reale informacion për provimet, vlerësimin gjatë vitit të bërë nga pegagoget e lëndës si edhe rezultatet përfundimtare të provimit. Gjithsesi, GVJ është i mendimit se kjo platform akoma nuk e ka arritur fazën e një sistemi informacioni tërësor për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit [<i>Vizitë në institucion; takim me stafin akademik, takim me studentët</i>].</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi Pitagora siguron një akses të dedikuar për studentët dhe personelin akademik. Sekretaria mësimore menaxhon dhe koordinon sistemin duke bërë edhe verifikimet në lidhje me përmbushjen nga ana e pedagoget për çdo student të rubrikavë të ofruara nga platforma, ndërsa janë bërë edhe verifikimet në lidhje me kryerjen e pagesës së tarifës studentore nga ana e studentëve përpara hyrjes së tyre në provime [<i>ev. RVB, takim në institucion, vizitë në Sekretarinë Mësimore</i>].</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi Pitagora nuk ka të integruar module/seksione qe mundësojnë forma të komunikimit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Numri i paket i tyre në këtë program studimi mundëson një komunikim interaktiv midis pedagogëve dhe studentëve duke i ndihmuar këta të fundit për shumë problematika që mund të hasin gjatë procesit mësimor. Shkëmbim informacioni bëhet në classroom ose përmes email-it ku stafi akademik dërgon skriptet dhe materiale shitesë që janë përdorur gjatë leksioneve apo seminareve [<i>ev. RVB, takim në institucion, takim me stafin akademik; takim me studentët</i>].</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Aksesi në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet faqes web të UAMD-së ku propozohet hyrja dedikuar e studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi i mundësohet sekretarisë mësimore të hedhë online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve dhe programeve përkatëse [<i>Ev. Vizita në institucion</i>]. Në mënyrë të veçantë në kushtet e pandemisë, u shfrytëzua gjerësisht platforma Google Classroom nëpërmjet të cilës postoheshin edhe materialet për çdo temë mësimore si dhe Google Meet për të mundësuar komunikimin online [<i>vizitë në Sekretarinë Mësimore, takim me stafin akademik; takim me studentët</i>].</p>

<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, sistemi i menaxhimit Pitagora garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët [Ev. RVB]. Informacione në lidhje me programin mesimor, aktivitetet e organizuara, mobilitetet etj jepen edhe në faqen zyrtare të UAMD-së</p> <p>[Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit - Universiteti "Aleksandër Moisiu" (uamd.edu.al)].</p>
---	--

Konkluzione:

UAMD ka ngritur një sistem të menaxhimit të informacionit. Rregulloret bazë përcaktojnë qartë veprimtarinë e çdo strukture. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. GVJ konstaton mungesë të: Rregjistrin themeltar të studenteve, Rregjistrin e arritjeve akademike dhe Rregjistrimin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

GVJ rekomandon: Pajisjen e Sekretarisë Mësimore me regjistrat bazë të cilët do të sigurojnë ruajtjen e një informacioni zyrtar në lidhje me çdo student në veçanti dhe për programin në tërësinë e tij.

Për menaxhimin e informatizuar të informacionit në UAMD është zhvilluar një sistem i emërtuar Pitagora i cili është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i UAMD-së.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjene studentëve

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të</p>	<p>GVJ u njoh me njësitë administrative përgjegjëse për hartimin e planeve financiare në Statut të UAMD-së. Neni 22 dhe 34 në Statut të UAMD-së përcakton qartë funksionet e Bordit të Administrimit. Ky Bord përbëhet nga shtatë anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme dhe është përgjegjës për miratimin e planit strategjik të zhvillimit të universitetit dhe mbykqyrjen e zbatimit të tij. Bazuar në nenin 38 në Statut të</p>

<p>paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UAMD-së, njësitë bazë dhe njësitë kryesore hartojnë projektbuxhetin mbështetur edhe në planin strategjik të zhvillimit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij.</p> <p><i>[Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD; Evidenca 8. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025].</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Hartimi i plan buxhetit për vitin ardhës dhe plan buxheti afatmesëm bazohet në kërkesat dhe standartet e përcaktuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Plan buxheti përfshin të gjithë zërat për të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>GVJ nuk pati shumë evidenca në lidhje me aktivitetin financiar të UAMD-së, raportet vjetore financiare të institucionit në tërësi dhe të NJKFTI-së në veçanti.</p> <p><i>[Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD]</i></p> <p>GVJ u mbështet në raportin e saj në tabelën përmbledhëse të të ardhurave në tre vitet e fundit ku janë pasqyruar edhe zërat kryesore në sigurimin e tyre në këtë institucion. Të ardhurat kryesisht janë nga Pushteti Qëndror, Grantet për Kërkim dhe kontratat, Tarifatat për shkollim i cili është zëri i dytë kryesor, shërbimet trajnuese dhe konsulencat si edhe aktivitetet tregtare kryesisht bare, kafe dhe residencat. Në lidhje me shpenzimet nuk kemi të dhëna dhe nuk mund të përcaktojmë qartë cilët elemente zënë më shumë bazuar edhe në Strategjinë për Zhvillim <i>[Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në Statut të UAMD-së, Bordi i Administrimit është përgjegjës për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm për të ushtruar kontrole dhe hartuar raporte mbi veprimtarinë financiare dhe administrative të universitetit <i>[neni 34 Statut të UAMD-së].</i></p> <p>Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit. GVJ nuk gjeti evidencë në lidhje me raportet e kryera nga auditimi I brendshëm dhe problematikat e gjetura në këto procese. UAMD i nënshtrohet edhe proceseve të auditimit të jashtëm ku përmendim MASH, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga nga Intitucione të tjera shtetërore financiare.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar</p>	<p>Në përfundim të vitit financiar njësisia bazë (DTI) raporton në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet dhe përmbushjen e objektivave financiare. DTI është përgjegjëse edhe për hartimin e një draft projekt buxhet për vitin pasardhës duke</p>

të vitit paraardhës.	bërë edhe parashikimet në lidhje me investimet në infrastrukturë, shpenzimet operative etj. <i>[takime në institucion]</i> .
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	GVJ nuk pati evidenca të mjaftueshme për të bërë një analizë të detajuar në lidhje me qëndrueshmërinë financiare. Gjithsesi GVJ bazuar në numrin e studentëve të regjistruar dhe takimet në institucion janë tregues që institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare të programit të studimit <i>[takime në institucion]</i> .

Konkluzione

- *GVJ konstaton vendosjen e strukturave përgjegjëse për aktivitetet financiare të institucionit. Veprimtaria e tyre bazohet në klauzolat ligjore të dhëna qartë në Statut të UMAD-së.*
- *GVJ ndonëse u njoh me të drejtat e njësisë bazë dhe kryesore në hartimin e plan buxhetit vjetor dhe afatmesëm, nuk mund të japë një analizë të detajuar të qëndrueshmërisë financiare të programit të studimit si rezultat i mungesës së të dhënave nga ana e institucionit në këtë drejtim.*
- *Veprimtaria financiare kontrollohet nga institucioni përmes Auditimit të Brendshëm dhe Bordit të Administrimit ndërsa UAMD si IAL Publike është subjekt kontrolli të jashtëm nga institucionet financiare shtetërore.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ përmes takimeve në institucion dhe dokumentacionit të paraqitur nga grupi i Vlerësimit të Brendshëm konstaton zbatimin e procedurave të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit 2 – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike”. Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statutin e UAMD-së -Kreu VII “Organizimi i studimeve”; • Rregulloren e IAL UMAD-së – Kreu III “Organizimi i studimeve”, Kreu VI “Të drejtat dhe detyrat e studentëve dhe organizimet studentore”; • Rregulloren e NJKFTI-së - Kreu III “Organizimi i Studimeve”; • Rregulloren e programit të studimit – Kreu II (neni 14-22), Kreu III “Vlerësimi i studentit” (neni 23-27), Kreu IV “Pranimi i studenteve” (neni 29-30); <p><i>[Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD; Evidenca 6. Rregullore IAL UMAD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit;].</i></p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e UAMD-së zhvillohet në përputhje me këto rregullore dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga UAMD janë të mirëpërcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në këtë program studimi. GVJ konstatoi se garancia e procesit mësimor sigurohet nëpërmjet përcaktimit në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe</p>

	<p>realizohet nga DTI dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse [Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD; Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit; Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin me korrektësi të procedurës së pranimit të studentëve. Bazuar në nenin 62 në Statut, UMAD ka theksuar se pranimi në programin e studimit është e mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave [Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD, neni 62].</p> <p>Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me pranimin e studentëve në programin 2 – vjeçar me karakter profesional ‘Specialist Pajisjesh Elektronike’. Propozimet për kriteret e veçanta burojnë nga Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit dhe miratohen me vendim të Senatit Akademik. GVJ u njoh me praktikë të Institucionit mbi kriteret e pranimit për vitin akademik 2022 të cilat më pas vijojnë me miratimet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) [Evidenca 24. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve; Evidenca 25. Vendim Dekanati për kriteret dhe kuotat].</p> <p>Kriteret e përgjithshme janë të shprehur në rregulloret bazë të institucionit dhe të programit të studimit [Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD, neni 62; Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit].</p> <p>Për vitin 2022 rezultojnë si kriter i përgjithshëm që kandidati të ketë mbaruar shkollën e mesme. Pështetja e mesatare sipas VKM-së (%) për këtë program studimi është 100%. Lista e shkollave ku do të konsiderohet koefiçienti 1.2 janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjinnazi; • Elektroteknikë; • Elektronikë; • Rrjete të dhënash; • Mbështetje e përdoruesve TIK;

- Zhvillim ëbsite;
- Inxhineri Informatike Softëare;
- Teknologji Informacioni;

ndërsa të gjithë shkollat e tjera të mesme sipas listes së MARS do të llogariten me koeficient 1. Ky program studimi nuk ka kriter të veçantë në lidhje me peshën e mesatares sipas gruplëndëve (kryesisht Matematikë). Mesatarja e pranimit në këtë program studimi është e ulët.

Programi i studimit	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë	Nota metasatare në hyrje
“Specialist Pajisjesh Elektronike”	2020-2021	41	6
	2021-2022	52	5.96
	2022-2023	25	6.05

[Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Specialist Pajisjesh Elektronike; takim në Sekretarinë Mësimore].

Në fillim të çdo viti akademik UAMD dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar. Procedura e pranimit bëhet sipas udhëzimit të MASR *[Evidenca 25. Vendim Dekanati për kriteret dhe kuotat; Evidenca 25. Vendim Dekanati për kriteret dhe kuotat].*

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallën pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. GVJ konstatoi se një ndihmesë të rëndësishme në procesin e informimit të kandidatëve për studentë dhe njohjes së kriterëve të pranimit dhe procedurave japin faqja web e institucionit [<https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024/>;

<https://uamd.edu.al/specialist-pajisjesh-elektronike/>],

broshura dhe flete palosje, Takimet informuese me shkollat e mesme, pjesëmarrja në panairët e shkollave kryesisht në zonën e Durrësit dhe të Tiranës *[takime në institucion].*

Kriteret e pranimit, vlerësimit të dijeve dhe transferimit janë të përcaktuar qartë në rregulloret bazë institucionale dhe në rregulloren e programit të studimit *[Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit].*

Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i diplomave është përcaktuar qartë edhe në nenin 74 në Statut të UAMD-së. UAMD ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve me të njëjtin cikël të studimit, brenda tij apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u njoh me procedura transferimi dhe verifikoi procedurat në lidhje me to [vizitë në sekretarinë mësimore]. Procedura e ç’regjistrimit është në përputhje me nenin 88 të Rregullores së UAMD-së.

Programi i studimit	Viti akademik	Studentë të c’regjistruar
“Specialist Pajisjesh Elektronike”	2020-2021	2
	2021-2022	3
	2022-2023	-

[evidencë:të dhëna nga vizita në sekretarinë mësimore]

Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.

Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në fillim të çdo viti akademik Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit përcakton kuotat dhe kriteret e pranimit të cilat bazuar edhe në rregulloren e FTI-së dhe të programit të studimit vijnë me miratimin në Dekanatin e FTI-së dhe të Senatit Akadmeik. GVJ konstaton zbatimin me korrektësi për çdo vit akademik të vendosjes së kriterëve të pranimit dhe konkludon se për këtë program studimi nuk ka kritere të veçanta [Evidenca 24. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve; Evidenca 25. Vendim Dekanati për kriteret dhe kuotat;]. IAL UAMD është Universitet Publik dhe i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi të veçanta ose për disa kategori të veçanta. Në lidhje me to UAMD aplikon dhënien e bursës shtetërore për kategoritë e përcaktuara në VKM dhe në politikat shtetërore si dhe në bazë të rezultateve akademike.

Konkluzione

- Politikat dhe procedurat e ndjekura nga UAMD janë të mirëpërcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në këtë program studimi.
- Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me pranimin e studentëve. Kriteret e përgjithshme janë të shprehur në rregulloret bazë të institucionit dhe të programit të studimit.
- IAL UAMD është Universitet Publik dhe i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në

fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi të veçanta ose për disa kategori të veçanta.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rregulloreve institucionale (IAL UAMD, Rregullore e NJKFTI-së, Rregullore e Programit të Studimit); Sekretarisë mësimore – e cila bazuar edhe në detyrat e përcaktuar në Statut dhe në Rregulloren e IAL UMAD (neni 83 në Rregulloren e UAMD-së). Sekretaria mësimore është përgjegjëse për administrimn e regjistrin të kursit, proces-verbalet e provimeve të ndërmjetme dhe finale rezultatet e të cilave i reflekton në platformën elektronike Pitagora dhe në regjistrin e arritjeve akademike. Broshura dhe fletpalosje dhe informacioneve në faqen ëeb të institucionit që i korrespondojnë jetës studentore ku jepet informacion i rëndësishëm në lidhje me programin [përmbajtja e kurrikulës, orari mësimor, personeli akademik etj.] <p><i>[https://uamd.edu.al/kalendari-akademik/; https://uamd.edu.al/departamenti-i-teknologjise-se-informacionit/; https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2022/11/SPE.pdf];</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Stafi akademik i cili bazuar edhe në detyrat dhe përgjegjësitë e tij i komunikon çdo informacion tek studentit, presanton syllabusin në fillim të vitit akademik, ndihmon në përgatitjen e studentit duke ndjekur progresin e tij dhe bën vlerësimin bazuar në përcaktimet ligjore të shprehur në Rregulloren e Programit të Studimit <i>[Evidenca 23. Rregullorja e programit]</i>.

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloret e FTI-së dhe DTI-së dhe të programit të studimit ka edhe kritere/procedura për njohjen e kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. Për studentët që regjistrohen si program i dytë ose transferohen në programin “Specialist Pajisjesh Elektronike”, komisioni ad-hoc bën njohjen e krediteve të fituara dhe ekuivalentimin e lëndëve.</p> <p>GVJ në vizitën e kryer në Sekretarinë Mësimore konstaton se në këtë program studimi nuk ka të transferuar në tre vitet akademike ndonëse në tabelën përmbledhëse në RVB janë dhënë për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 nga 1 student <i>[evidencë: vizitë në Sekretarinë Mësimore]</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, në javën e parë të semestrit studentët informohen prej stafit akademik dhe prej secilit pedagog në lëndën përkatëse, mbi elementet e programit të lëndës, duke përfshirë dhe vlerësimim. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse <i>[Ev. RVB; Takime në institucion]</i> Kriteret në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve janë dhënë qartë në rregulloret bazë. GVJ konstaton shprehjen e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statutin e UAMD-së -Kreu VII “Organizimi i studimeve”; • Rregulloren e IAL UMAD-së – Kreu III “Organizimi i studimeve”, Kreu VI “Të drejtat dhe detyrat e studentëve dhe organizimet studentore”; • Rregulloren e NJKFTI-së- Kreu III “Organizimi i Studimeve”; • Rregulloren e Programit të Studimit – Kreu II (neni 14-22), Kreu III “Vlerësimi i studentit” (neni 23-27), Kreu IV “Pranimi i studentëve” (neni 29-30); <p><i>[Evidenca 5. Statuti-miratuar-UAMD; Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD; Evidenca 7. Rregullore NJKTI; Evidenca 23. Rregullorja e programit;].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e</p>	<p>Programi i studimit 2 – vjeçar me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” përmban Provimin Përfundimtar si element mësimor i vlerësuar me 6 ECTS në kategorinë “E” <i>[Evidenca 18. Plani mesimor i programit të studimit]</i>. Për të fituar diplome profesionale në programin e</p>

<p>studimit.</p>	<p>studimit “Specialist pajisjesh elektronike” studenti duhet të kalojë provimin/punimin e diplomës.</p> <p>Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së provimit/punim diplome studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore, duke fituar 114 kreditet e nevojshme.</p> <p>Mënyra e organizimit dhe vlerësimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës përcaktohet qartë në nenin 21 të rregullores së programit të studimit.</p> <p>Studentëve u ofrohet edhe një bazë pyetjesh orientuese për të studiuar sipas programit të studimit ku bëjnë pjesë bazuar në Neni 62 në Rregulloren e DTI-së e cila përcakton:</p> <p><i>“Teza e provimit të diplomimit bazohet në 5-6 kurse/module bazë të programit të studimit të cilat përcaktohen çdo vit me propozim nga departamentet dhe me vendim dekanati. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bëjnë të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit.”</i></p> <p>Njësia bazë e Teknologjisë së Informacionit informon studentët në lidhje me organizimin dhe vlerësimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës. Pyetje baze u jepen paraprakisht studentëve për përgatitje. Drejtuesi i njësisë bazë është përgjegjës për ngritjen e një komisioni ad-hoc për provimin, i përbërë të paktën nga 3 anëtarë të personelit akademik. Provimi i diplomës zhvillohet me një provim të vetëm me 1000 pikë që përmban pyetje nga të gjitha kurset modulet bazë të përcaktuara nga departamenti. Raporti i pikëve sipas kurseve përcaktohet me vendim të departamentit. Rezultatet e provimit i bëhen të ditur studentit jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. Në takimin e zhvilluar me studentët, GVJ konstaton se ata ishin në dijeni të mënyrës së organizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar <i>[takim me studentët]</i>.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>GVJ konstaton se studentët, janë të njohur dhe të qartë, lidhur me programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në javën e parë që quhet edhe ‘java e orientimit’, studentët informohen me rregullat e përgjithshme të funksionimit të Universitetit, programit të studimit, lëndëve, sekretarisë, etj.</p>

Konkluzione

- Studentët e programit të studimit janë të informuar përmes dokumentave institucionale ku përmendim Rregullore të UAMD-së, dhe Rregullore të programit të studimit.
- Informim tek studentët jep edhe Sekretaria Mësimore.
- Faqja zyrtare web është aktive dhe rubrika të vecanta të saj japin informacione të nevojshme në lidhje me programin mësimor. Institucioni informon studentët dhe publikun edhe përmes broshurave, fletëpalosje dhe fushata informimi.
- Në javën e parë të semestrit studentët informohen prej stafit akademik dhe prej secilit pedagog në lëndën përkatëse, mbi elementet e programit të lëndës, duke përfshirë dhe vlerësimin. Syllabusi u vihet në dispozicion studentëve.
- GVJ konstaton se studentët, janë të njohur dhe të qartë, lidhur me programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në javën e parë që quhet edhe 'java e orientimit', studentët informohen me rregullat e përgjithshme të funksionimit të Universitetit, programit të studimit, lëndëve, sekretarisë, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre <i>[Evidencë: Takime në institucion]</i> . Informacioni në lidhje me këta elementë shpërndahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, notat etj <i>[Evidencë: Takime në institucion]</i> .

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se vënia në dispozicion të informacionit të rëndësishëm në lidhje me programin mësimor është atribut i Koordinatorit të Programit (detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë shprehur qartë në rregulloret bazë dhe të programit të studimit), stafit akademik të angazhuar drejtpërdrejt në procesin mësimor, sekretarisë mësimore dhe Qendrës së Komunikimit, Karrierës & Alumni.</p> <p>GVJ konstatoi se një burim i rëndësishëm informacioni për studentët është edhe platforma Google Meet/Classroom duke mundësuar postimin e materialeve për çdo temë mësimore si dhe për të mundësuar komunikimin online. <i>[Ev. Takime në institucion]</i>. Kurrikula e programit është e paraqitur edhe në faqen web të institucionit ku çdo student i interesuar mund të marrë informacion në lidhje me përmbajtjen e saj <i>[https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2022/11/SPE.pdf]</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UAMD ka në strukturën e saj organike Sektorin e Komunikimit, Alumnit & Karrierës, përfaqësuesit e së cilës i takoi edhe GVJ. Kjo zyrë funksionin mbi bazën e një rregullore të përcaktuar qartë dhe ka dy zyra përkatësisht në godinen e Currilave ku zhvillohet edhe programi mësimor dhe në Kampus. Kjo zyrë e ka për detyrë dhe informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. GVJ zhvilloi një takim të veçantë me këtë zyrë dhe u njoh me punën e organizuar në lidhje me punësimin e studentëve. Ndonëse rezultatet janë të kënaqshme, për këtë program studimi nuk ka shumë të dhëna në lidhje me gjurmimin e studentëve pasi edhe numri i të diplomuarve është shumë i vogël (vetëm 1 student i diplomuar).</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën e logjistikën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Orari mësimor publikohet online dhe është i afishuar në vende të dukshme. Klasat janë të pajisura me tregues të cilat orientojnë qartë studentin. Godina e Currilave është e pajisur edhe me ashensor për të mundur një akses sa më të lehtë të lëvizjes së studentëve në kate veçanërisht për studentët me aftësi të veçanta <i>[vizitë në institucion]</i>.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të</p>	<p>Programi i studimit nuk ofron praktikë profesionale.</p>

studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	
--	--

Konkluzione:

GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Platforma Google Meet/Classroom dhe web japin informacion studentëve në lidhje me procesin mësimor. Në shërbim të studentëve janë Koordinatori i programit të studimit, zyra e Komunikimit, Karrierës & Alumni. Programi i studimit nuk ofron praktikë profesionale dhe GVJ nuk mund të japë mendim në lidhje me mundësinë e bashkëpunimit me partnerët në këtë drejtim.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi				
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UAMD përmes Sekretarisë Mësimore dhe Sektorit të Teknologjise se Informacionit (IT) menaxhon informacion statistikore në lidhje me studentët në këtë program studimi. Të dhënat janë vjetore dhe mbahen në formë të shkruar dhe elektronike. Platforma Pitagora ndihmon në lidhje me vlerësimet e stafit akademik për çdo provim, frekuentimet dhe detyrimet e studentëve. Në RVB është theksuar edhe roli i Sektorit të Komunikimit, Karrierës & Alumni në lidhje me mbajtjen e statistikave për studentet e diplomuar dhe gjurmimin e tyre. GVJ vlerëson rolin e kësaj strukture por në këtë program studimi efekti i punës së saj është i pandjeshëm duke konsideruar që vetëm 1 student është diplomuar në këtë program studimi. Referuar vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon:				
	<table border="1"> <tr> <td>Viti akademik</td> <td>Nr i të regjistruarve</td> <td>Nr i të ç' regjistruarve</td> <td>Nr aktual</td> </tr> </table>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të ç' regjistruarve	Nr aktual
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të ç' regjistruarve	Nr aktual		

	2020-2021	41	2	39
	2021-2022	52	3	49
	2022-2023	25	0	25
	Totali	113		
	Studentë të diplomuar:			
	Numri total i studentëve të diplomuar	2020-2021	2021-2022	2022-2023
		1	-	-
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Sipas kërkesave ligjore, institucioni ka të detyrueshme ruajtjen e të dhënave si Regjistri Themeltar, Regjistri i Arritjeve Akademike (notave) dhe Regjistri i Lëshimit të Diplomave në dy forma: hardcopy dhe në formë dixhitale. GVJ konstatoi se për këtë program studimi institucioni nuk është pajisur nga QSHA me regjistrat bazë dhe thekson punën që duhet bërë nga institucioni në këtë drejtim për sigurimin brenda një kohë të shkurtër të dokumentave bazë ligjore <i>[Ev. Takime në institucion]</i>.</p>			
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p>Institucioni ka krijuar struktura të qëndrueshme në lidhje me procesin e menaxhimit të informacionit të studentëve aktive në programin mësimor 2 – vjeçar “Specialist Pajisjesh Elketronike”.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit (IT)-së kryejne funksionin e tyre mbi bazën e rregulloreve ku janë përshkruar qartë detyrat dhe përgjegjësitë <i>[Evidenca 28. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; Evidenca 6. Rregullore IAL UAMD]</i>.</p> <p>Drejtorja e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike ka në varësinë e saj Sektorin e Teknologjisë së Informacionit në të cilën angazhohen 3 specialistë. Fokusi kryesor i veprimtarisë së këtij sektori është mirë-administrimi i çdo çështje që lidhet me promovimin e strategjisë së sistemeve të informacionit dhe IT-së nëpërmjet kontrollit, auditimit dhe raportimit të operimit të sistemeve informatike. Aktiviteti i këtyre dy sektoreve është subjekt kontrolli të vazhdueshëm nga Rektorati dhe për Njësinë Kryesore FTI nga Zv/Dekani për procesin mësimor.</p>			
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse	Njësia bazë DTI harton raporte në lidhje me veprimtarinë e			

për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	procesit mësimor, cilësinë e pranimit të studentëve, progresin dhe numrin e studentëve të diplomuar bazuar mbi të dhënat statikore të mbledhura në Sekretarinë Mësimore. Në raporte reflektohen edhe problematikat nga gjetjet e NJSBC-së përmes anketimeve të kryera me studentët për përmbajtjen e programit mësimor, vlerësimin për personelin akademik dhe infrastrukturën. Raportet shoqërohen edhe me rekomandimet përkatëse në lidhje me përmirësimet e duhura [evidencë 37: memo analiza vjetore update 20-21].
--	---

Konkluzione:

- *GVJ konstaton struktura të ngritura Brenda Institucionit në lidhje me menaxhimin e të dhënave të studentëve.*
- *Sekretaria Mësimore dhe Drejtoria e IT menaxhojnë informacion statistikore në lidhje me studentët në këtë program studimi. Njësia bazë DTI harton raporte në lidhje me veprimtarinë e procesit mësimor, cilësinë e pranimit të studentëve, progresin dhe numrin e studentëve të diplomuar bazuar mbi të dhënat statikore të mbledhura në Sekretarinë Mësimore.*
- *DTI harton raporte vjetore në lidhje me ecurinë e programit të studimit duke përcaktuar edhe hapat në drejtim të përmirësimit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstatoi se UAMD ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Këshillat e Studentëve (Neni 90 në Statutin e UAMD) janë organizma të pavarura të studentëve të UAMD-së, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të UAMD-së në të gjitha programet e studimit. Sipas udhëzimeve edhe GVB për çdo program studimi në kuadër të akreditimit të

	<p>tyre përfshijnë anëtarë -studentë.</p> <p><i>Ref: 17_Statuti UAMD + Urdher MASR_385, 09.07.2019.pdf (Neni 90)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UAMD/FTI kanë garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në bord dhe në Senatin akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Mendimi i studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të UAMD-së. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve tërhiqet, ndërmyjet të tjerash, mendimi elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën 20%. Struktura e tij është e pandryshuar që në momentin e liçencimit të tij nga MASR. Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u theksua përmirësimi i përmbajtjes së syllabusit duke përmirësuar tematikat. Ndryshimi ka konsistuar si pasojë edhe të kërkesës së studentëve të cilët kanë shprehur mendimin e tyre në lidhje me tematika ku është kërkuar një trajtim më i veçantë <i>[takim në institucion]</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve u kërkohet mendim mbi procesin e vlerësimit të dijeve, barazinë apo ndershmërinë e këtij procesi, duke përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e FTI/DTI personelit akademik përgjegjës. Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit e cila shprehet qartë në Statut dhe në Rregulloren e UMAD-së, FTI dhe programit të studimit. Programi i studimit ka edhe Koordinatorin e tij i cili mban</p>

	<p>kontakte të vazhdueshme me studentët dhe përcjell shqetësimet e këtyre të fundit në Njësinë Bazë dhe në Dekanat të FTI-së.</p> <p><i>[takime në institucion]</i></p>
--	---

Konkluzione:

UAMD/FTI kanë garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në bord dhe në Senatin akademik.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se në organigramën e UAMD ka njësi të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektori Pagesave të Studenteve, • Sektori i Kominikimit Alumni & Karrierës, • Sektori i Çështjeve Mësimore, • Sekretaria mësimore, etj <p>në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të saj. Këto njësi kanë procedura gjithëvjetoare në shërbim të studentëve dhe rregullore të funksionimit të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me rregjistrimin dhe avancimin akademik të tyre, një rol të veçantë luan Koordinatorin e Programit i cili jep ndihmesë lidhur me ndjekjen e ecures së studentëve në institucion si dhe për të parë e trajtuar problematikat që ata kanë <i>[Evidenca</i></p>

	<p><i>23. Rregullorja e programit, neni 10]. Nga organigrama dhe nga RVB kontatojme se Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në varësi të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike është struktura përgjegjëse që zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë [Evidenca 28. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike;].</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra për Komunikimin, Karrieren & Alumni u ofron studentëve një numër shërbimesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndjekje dhe organizim i çështjeve të karrierës së studentëve;</i> - <i>Organizimin e panairit të Punës ku studentët kanë mundësi të njihen me kompanitë dhe kërkesat e tyre në lidhje me punësimin;</i> - <i>Kurse trajnimi mbi hartimin e CV, procedurat së intervistës etj.</i> - <i>Seminare të hapura ku përfaqësues të biznesit ftohen të japin eksperiencën e tyre;</i> - <i>Ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve;</i> - <i>Bashkëpunon ngushtë me departamentet e fakulteteve për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve;</i> - <i>Mban kontakte me alumni dhe bën gjurmimin e punësimit të tyre;</i> <p>GVJ rithekson se ndonëse veprimtaria e kësaj zyre është për tu konsideruar impakti i punës se saj në këtë program studimi nuk është i ndjeshëm për shkak të mungesës së praktikës profesionale në programin e studimit dhe për shkak të numrit të ulët të studentëve të diplomuar.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>				
<p>Konkluzione:</p> <p><i>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës përmes Zyrës së Komunikimit, Karrierës & Alumni. GVJ rithekson se ndonëse veprimtaria e kësaj zyre është për tu konsideruar impakti i punës se saj në këtë program studimi nuk është i ndjeshëm për shkak të mungesës së praktikës profesionale në programin e studimit dhe për shkak të numrit të ulët të studentëve të diplomuar.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kërkesa e tregut të punës për specialistë të pajisjeve elektronike është e lartë;
2. Programi i studimit është unik në Republikën e Shqipërisë;
3. Lëndët e programit të studimit ofrohen nga personeli akademik në përputhje me fushën e ekspertizës së tyre. Ngarkesa mësimore mbulohet kryesisht nga staf akademik efektiv i motivuar dhe me kualifikimin e duhur për të garantuar cilësinë e mësimdhënies;
4. Ngarkesa mësimore mbulohet kryesisht nga staf akademik efektiv i motivuar dhe me kualifikimin e duhur për të garantuar cilësinë e mësimdhënies;
5. UAMD mbështet institucionalisht programin e studimit duke krijuar një infrastrukturë në përputhje me standartet për zhvillimin e procesit mësimor;
6. UAMD kryen analiza vjetore gjithëpërfshirëse, kryen anketime me studentët për vlerësimin e stafit akademik, për kushtet e studimit dhe për problematika të tjera të lidhura me programin e studimit;

b. Pika të dobta:

1. Programi i studimit trajton me të njejtën rëndësi të gjitha lëndët në të gjitha kategoritë. GVJ mendon se disa lëndë (kryesisht bazë) kanë peshë më të “rëndë”, se sa i duhet këtij programi; *[Standarti II.4, Kriteri 1; Standarti III.4, Kriteri 1]*
2. Baza laboratorike në fushën e elektronikës nuk ka qenë adekuate për programin mësimor; *[Standarti IV.2, kriteri 3]*
3. Mungesë e zhvillimit të praktikës profesionale; *[Standarti II.3, Kriteri 3; Standarti II.4, Kriteri 2; Standarti II.4 Kriteri 6;]*
4. Mungesë e tematikave të orëve të ushtrimeve dhe punëve laboratorike gjatë procesit të orës së integruar mësimore; *[Standarti II.3, Kriteri 3; Standarti II.4, Kriteri 2, Kriteri 3, Kriteri 4; Standarti III.1, Kriteri 1;]*

Rekomandime

1. GVJ rekomandon që hapa të mëtejshëm duhen kryer për të matur tendencat e tregut të punës në shërbim të përmbajtjes së programit të studimit dhe të studentëve;
2. GVJ rekomandon përfshirjen e objektivave formues në Rregulloren e Programit të Studimit;
3. GVJ rekomandon paraqitjen në planin mësimor të ngarkesës për orë ushtrimesh dhe orë laboratorike;
4. DTI duhet të vendosë Praktikën profesionale si një lëndë e veçantë dhe shumë e rëndësishme për programet e studimit të këtij lloji;
5. GVJ rekomandon një rishikim të lëndëve në programin mësimor, duke pëcaktuar realisht peshën e secilës në raport me rëndësinë e tyre;
6. GVJ rekomandon hartimin e një pyetsori të veçantë për këtë program studimi, meqënëse alumni dhe bashkëpunimi me kompanitë e biznesit mungojnë dhe kështu nuk përthithet mendimi i tyre nga institucioni;
7. Institucioni duhet të pajisjë Sekretarinë Mësimore me regjistrat bazë, të cilët do të sigurojnë ruajtjen e një informacioni zyrtar në lidhje me çdo student në veçanti dhe për programin në tërësinë e tij;

Evaluation's conclusions for the professional study program "Specialist for Electronic Equipments"

a. Strengths and affirmations:

1. The labor market demand for electronic equipment specialists is high;
2. The study program is unique in the Republic of Albania;
3. The courses in the study program offered by the academic staff are in compliance with their field of expertise;
4. The teaching load is mainly covered by motivated effective academic staff with the appropriate qualification to guarantee the quality of teaching;
5. HEI AMD institutionally supports the study program by establishing an infrastructure in accordance with the standards for learning process;
6. HEI AMD conducts annual comprehensive analyses, surveys with students to evaluate academic staff, as well as study conditions and other issues related with study programme;

b. Weaknesses:

1. The study program consider courses in all categories with equal importance. EEG thinks that some subjects have more "heavy" weight than this program needs; *[Standard II.4, Criteria 1; Standard III.4, Criteria 1]*
2. The laboratory infrastructure in the field of electronics was not adequate for the curriculum *[Standard IV.2, Criteria 3]*
3. Lack of professional practice development *[Standard II.3, Criteria 3; Standard II.4, Criteria 2; Standard II.4 Criteria 6;]*
4. Lack of thematic for practice hours and laboratory work during the process of the integrated lesson *[Standard II.3, Criteria 3; Standard II.4, Criteria 2, Criteria 3, Criteria 4; Standard III.1, Criteria 1;]*

Recommendation

1. EEG recommends that further steps should be taken to measure labor market trends with regard of students and study program content;
2. EEG recommends the inclusion of objectives in the Study Program Regulation;
3. EEG recommends involvement in the teaching plan the workload for practice and laboratory hours;
4. DTI should establish Professional Practice as a special and very important subject for study programs of this category;
5. EEG recommends a review of the courses in the curriculum, by realistically determining their load in accordance with their importance;
6. EEG recommends drafting a special questionnaire for this study program, since alumni and business companies are missing and thus their opinion is not gathered by the institution;
7. The institution should supply main registers at Secretary Office in order to ensure the preservation of official information individually for each student as well as for the entire study program;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


